

GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7731 E premte 7 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Më datë 5 dhjetor 2018, Teatri i Metropolit organizoi një tryezë të rrumbullakët, me synimin për të marrë mendime nga një grup ekspertësh ...
Vijon në faqen 20

Nga VALBONA NATHANAILI
Përthyerje për të qëmtuar: Teatri i Metropolit ndërmjet zgjedhjeve dhe zgjidhjeve


Opinion *i* **Ditës**
E di Rama i është përgjigjur me një mendësi prej matrapazi, njërës prej protestave më xhenuine, më inteligjente dhe më të çiltër që prej kohës së armëve ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Kryeministri i të pasurve po përballat me revoltën e të varfërve




Dëmshtëpërblimi/ Emrat e përfituesve
Trashëgimtarët e të përndjekurve, lista e re e atyre që marrin paratë

Kush nuk e ka dorëzuar ende, duhet të japë llogarinë bankare dhe kopjen e ID

Ministria e Financave ka publikuar listën emërore të trashëgimtarëve të ish-të përndjekurve politikë, të cilët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë bankare dhe një fotokopje karte identiteti ose pasaporte, në mënyrë që të marrin paratë e dëmshtëpërblimit. Për ata që kanë një llogari aktive bankare dhe e kanë dorëzuar ...

Në faqen 11-13

PROTESTA/ TE RINJTE: TE PERGJYSMOHEN TARIFAT, JO "GJOBE" PER VJESHTEN MIJERA STUDENTE NE RRUGE, QEVERIA TERHIQET PJESERISHT

Lindita Nikolla: Shfuqizojmë VKM për provimet e mbartura. Zbardhen tarifatat për çdo universitet. Meta: Rinia, aset i çmuar kombëtar. Sot, protestë te kryeministria



(Në foto) Protesta e studentëve para Ministrisë së Arsimit

PROTESTA
Unaza e Re, Basha: Projekti duhet të kushtonte 10 herë më pak
Në faqen 5

BIZNESMENI
Hetimi për pastrim parash, Ylvi Beqja dëshmon në prokurori kundër Shullazit
Në faqen 9

ITALI
Trafiku i drogës, shqiptarët pjesë e të arrestuarve të "Ndrangheta"
Në faqen 8

KULTURE
"Kavaliери i Krujës", shfaqet në Romë filmi i xhiruar më 1940
Në faqen 18

LEKSIONI I HAPUR



Profesoresha e Oksfordit te "Luarasi": Kërkoni gjithnjë të drejtën
Në faqen 10

Përfaqësuesit e PD-LSI ishin për herë të fundit në Kuvend më 19 korrik

Bojkoti, 28 deputetët që rrezikojnë mandatin

Honoraret dhe dietat, përfituesit më të mëdhenj: Braho, Leka, Xhixha

Afro gjysma e deputeteve të opozitës mund të humbasin mandatin, nëse brenda dhjetorit nuk shkojnë goftë edhe një herë të vetme në parlament. Kjo, pasi ata kanë thuhajse 5 muaj plot që bojkotojnë çdo aktivitet parlamentar dhe për rrjedhojë rrezikojnë të preken nga



përcaktimi që bën Kushtetuta që mandati i deputetit mbaron apo është i pavlefshëm kur mungon pa arsye për 6 muaj resht në Kuvend. Janë plot 28 deputetë të PD, LSI e partive të tjera aleate, të cilët për herë të fundit kanë qenë në parlament në 19 korrik e pikërisht ...

Në faqen 7

Në faqen 18

PROTESTA E STUDENTEVE REAGIMET DHE NDRYSHIMET



RROKAJ: STUDENTËT KANË TË DREJTË

"Studentët kanë gjithmonë të drejtë, sepse arsimit gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit nuk e kanë parë arsimin si prioritet për ta vendosur arsimin në ato shina siç është në vendet perëndimore. Buxheti i fundit për arsimin është i pa mjaftueshëm. Mos subvencionimi i arsimit nga qeveria çoi në rritjet tarifash për studentët"- tha zv rektori i universitetit të Tiranës, Shezai Rrokaj.

Sot sërish protestë para Kryeministrit: Të plotësohen të gjitha kërkesat tona

Mijëra studentë në protestë kundër tarifave të larta

"Ne nuk paguajmë haraç, nuk jemi bankomat"

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, mijëra studentë të universiteteve publike në vend kanë protestuar kundër tarifave të larta e një sërë kërkesash të tjera para Ministrit të Arsimit. Turma masive e të rinjve me pankartat ndër duar ka bllokuar rrugën e Durrësit mëngjesin e së enjtes, duke kërkuar mbi të gjitha shfuqizimin e VKM nr 288 që i detyron të paguajnë tarifën prej 670 lekësh për kredit për provimet e mbartura. Nën sloganet "Ne nuk jemi dele"; "Ne nuk paguajmë haraç"; "VKM është VK"; "Shfuqizoni VKM"; "Dija është nevojë"; "Mos na vrisni të ardhmen"; "Dua Shqipërinë si gjithë Europa"; "Jo politike" "Ne nuk jemi bankomat"; studentët kanë marshuar drejt godinës së MASR ndaj së cilës kanë hedhur vezë e letra higjienike. "Tarifat e vendosura nga qeveria janë të papërbalueshme për xhepat tanë e të familjeve. Nuk mund të paguajmë gjoba e haraç për qeverinë. Kërkojmë të drejtat tona. Ne nuk tërhiqemi", - thotë studentja Mema për "Gazeta Shqiptare".



Protesta e djeshme e studentëve

S'PAGUJME HARAÇ

"Tarifat e vendosura nga qeveria janë të papërbalueshme për xhepat tanë e të familjeve. Nuk mund të paguajmë gjoba e haraç për qeverinë. Kërkojmë të drejtat tona. Ne nuk tërhiqemi", - thotë studentja Mema për "Gazeta Shqiptare".

STUDENTET

"Kërkesat tona janë: anulimi i vendimit të këshillit të ministrave nr.288 të miratuar më datë 21.05.2018 sidomos pikës 4 që i vendos një gjobë studentëve për provimet e mbartura; rritjen e buxhetit të shtetit për universitetet publike; përgjysmim të të gjitha tarifave universitare".

Ministria Nikolla: Grupe pune për kërkesat e tjera

Qeveria dorëzohet para studentëve, shfuqizon VKM për provimet e mbartura



Në një kohë që studentët po protestonin, ministria e Arsimit Lindita Nikolla ka njoftuar pasditën e djeshme se qeveria do shfuqizojë VKM nr. 288 pika numër 4. "Studenti, i cili ushtruar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës në një lëndë apo në shumë lëndë dhe vijon studimet në vitin pasardhës, i nënshtrohet tarifës së shkollimit për kredit për detyrimet apo lëndët përsëritëse, si dhe tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet", - citohet në këtë VKM e cila është shfuqizuar dje. Ministria shtoi se pas shfuqizimit të VKM, do të ngrihen grupe pune (me pjesëmarrjen e studentëve) për zgjidhjen e tre kër-

save të tjera. "Faleminderit që keni përcjellë të gjithë komunikimin në këto ditë. Më vjen mirë që kam marrë reagim inkurajues nga disa këshilla studentorë. Kemi kohën që presim një angazhim edhe më

të madh të studentëve për modernizimin e çdo institucioni të arsimit të lartë. Kjo protestë tregon se sa pak informacion dhe sa pak komunikim kishte të studentët për atë që sjell reforma e arsimit

të lartë. Më shumë se sa rëndësia për të shfuqizuar pikën 4 të VKM kjo protestë ia vlejti shërbeu si një katalizator për një debat shterues brenda universitetit. Kam marrë një kërkesë nga këshillat studentorë që e miratojmë të dy duart që të ngrihen grupe pune për 3 pikat e tjera. Jam shumë dakord për të ndërtuar një dialog ku çdo aktor në jetën e universitetit t'i bëjë transparente për gjithçka që bëhet në jetën universitare", - tha ministria Nikolla.

Kryeministritë. "Qeveria dhe ministria u tërhoqën nga haraçi i padrejtë për studentët! Por nuk kanë plotë-

suar kërkesat e tjera dhe po përpiqen t'u bishtojnë! Ama ne nuk ndalem! Nesër vazhdon protesta deri në realizimin e plotë të kërkesave. Në orën 8.00 bojkotojmë në çdo fakultet/ universitet, ndërsa në orën 10.00 fillon protesta për plotësimin e kërkesave e reagimin nga instancat përkatëse", - thonë studentët për "Gazeta Shqiptare".

KËRKESAT

Studentët kërkojnë përgjysmim të tarifave në institucionet publike, si dhe përmirësim të kushteve të jetesës në konvikte. "Kërkesat tona janë: anulimi i vendimit të këshillit të ministrave nr.288 të miratuar më datë 21.05.2018 sidomos pikës 4 që i vendos një gjobë studentëve për provimet e mbartura; rritjen e buxhetit të shtetit për universitetet publike; përgjysmim të të gjitha tarifave universitare. Ndërsa nga autoritetet e drejtuesve kërkojmë: ndarjen e pagesës së tarifës në këste; shtyrjen e afatit të pagesës së secilit këst përtej sezonit të provimeve të semestrit të parë", - thekson një prej studentëve për "Gazeta Shqiptare".

STUDENTËT NUK TËRHIQEN

Pavarësisht se ministria e Arsimit, Lindita Nikolla ka

shfuqizuar dje VKM për tarifën e provimeve të mbartura, studentët sërish nuk u ndalën. Ata kërkojnë plotë-

simin e 4 kërkesave të tyre, e bëjnë thirrje që sot do të bojkotojnë sërish mësimin e do të protestojnë para



MARKU: POLITIKË ARROGANTE

"Shenjë pozitive, që ka reagim masiv, mbas vitit 90 është lëvizja më e madhe në universitetet shqiptare. Janë politikat e qeverisë shqiptare që janë arrogante, taksim 100-fish, mungesë perspektive. Studentët po reagojnë për të drejtat e tyre, për gjithçka ka ndodhur në këto vitet e fundit. Nuk më duket aspak politike", -tha Mark Marku, shefi i Departamentit të Gazetarisë në Fakultetin e Histori-Filologjisë.



MUKA: TË BASHKOHEMI ME STUDENTËT

"Kjo rini është shpresa, dhe të gjithë duhet t'i bashkohemi! Prindër mos i lini nesër fëmijët vetëm, por bashkohuni me ta kundër tarifave të larta dhe një arsimit që nuk ofron dije. Forca rini, momenti është i juaji. Ju kanë frikë, forca juaj është e madhe!", - thotë ish-zv ministri i Arsimit Taulant Muka.



Kuçi: Absurde, duhet të bëjmë llogaritë para së te hyjmë në universitet

Kërkesat e studentëve, zbardhen tarifat që duhet të paguajnë për shkollimin

"Masteri deri në 3 milionë e 200 mijë lekë të vjetra"

Voltiza Duro

Mijëra studentë në mbarë vendin kanë bojkotuar mësimin dy ditët e fundit në shenjë revolte kundër tarifave të larta. Por sa janë tarifaf e shkollimit nëpër universitetet publike? "Gazeta Shqiptare" zbardh sot masën e parave që duhet të paguajnë studentët në 12 institucione të arsimit të lartë publik, si në nivelin Bachelor, dhe në atë Master.

NIVELI BACHELOR
Tarifat për një vit studimi në universitetin e Tiranës variojnë nga 25-40 mijë lekë të rinj; në universitetin e Mjekësisë 35-45 mijë lekë të rinj; në universitetin Politeknik të Tiranës 25-40 mijë lekë të rinj dhe në Universitetin Bujqësor variojnë nga 27-90 mijë lekë të rinj. Universiteti i Arteve ka një tarifë fikse prej 400 mijë lekësh të vjetër, ndërsa ai i Sporteve nga 23 deri në 45 mijë lekë të rinj për një vit akademik. Tarifaf në universitetet e rretheve variojnë nga 20-30 mijë lekë të reja.

NIVELI MASTER
Sipas të dhënave nga organizata Qëndresa Qytetare, tarifa më e lartë në nivelin master është në Universitetin e Arteve ku studentët duhet të paguajnë deri në 3 milionë e 200 mijë lekë të vjetra. Ndërkohë në universitetin e Tiranës tarifa e masterit varion nga 1 milionë e 200 deri në 1 milionë e 680 mijë lekë të vjetra; në universitetin e Mjekësisë nga 720 mijë-1 milionë lekë të vjetra; në Universitetin Politeknik studentët duhet të paguajnë 810 mijë deri në 1 milionë e 820 mijë lekë të vjetra për dy vite. Një student që këtë tarifë nuk e paguan brenda afatit të përcaktuar, ai automatikisht penalizohet duke mos u futur në provim. Që të përfitosh nga ulja ose mospagesa e saj, duhet të jesh ose me af-

UNIVERSITETET PUBLIKE	TARIFA PËR NIVELI I PARË I STUDIIMIT(BACHELORI) NË LEKË	TARIFA PËR NIVELI I DYTË I STUDIIMIT(MASTERI) NË LEKË
Universiteti i Tiranës	25 000 - 40 000	120 000 - 168 000
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	35 000 - 45 000	72 000 - 105 000
Universiteti Politeknik i Tiranës	25 000 - 40 000	81 000 - 181 709
Universiteti Bujqësor i Tiranës	27 000 - 90 000	60 000 - 80 000
Universiteti i Arteve, Tiranë	40 000	220 000 - 320 000
Universiteti i Sporteve, Tiranë	23 000 - 45 000	95 700 - 270 000
Universiteti Aleksandër Moisu, Durrës	25 000	120 000 - 168 000
Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan	25 000 - 30 000	72 000 - 90 000
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	20 000	90 000 - 150 000
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	25 000	111 000 - 233 000
Universiteti Ismail qemali, Vlorë	20 000	86 000 - 233 900
Universiteti Egerem Cabej, Gjirokastrë	20 000 - 25 000	111 000 - 203 000

tësi të kufizuara (dhe kjo e vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë), ose të jesh i/e verbër/ tetraplegjik/ paraplegjik, njërin nga prindërit ta kesh patur të përndjekur politik, ose të kesh statusin e jetimit etj. "Me një nivel ekonomie të ulët, ku rroga mesatare nuk i kalon 250 mijë lekë të vjetra në muaj, sigurisht që këto tarifaf janë shumë të larta. Tarifaf janë absurde, pavarësisht standardeve e kualitetit të fakultetit ku bëjmë pjesë. Në vende të tilla si Greqia, Franca, Sllovenia, Finlanda etj., përveçse gjejmë universitete me tarifë 0, ato ndjekin dhe politika të posaçme për t'u lehtësuar jetesën studentëve.

Të qenit student është kosto më vete, nëse vendos të vazhdos studimet e larta, duhet të bësh disa llogari më vete si: nëse do kesh mundësi të përballosh tarifën ulëritëse, nëse do

mundesh të paguash qiranë, të ushqehesh, të vishesh etj. Një student në Shqipëri nuk mund ta gëzojë plotësisht statusin e studentit. Ai si fillim ka statusin e të punësuarit, ku gjysmën e ditës i duhet të shërbejë për llogari të dikujt tjetër, e gjysmën tjetër i duhet të frekuentojë leksionet e seminarat. Praktikisht atij nuk i ngelet as kohë të lexojë, studiojë e as të punojë për ndonjë detyrë a projekt që mund t'i jepet", thotë studentja Klaudina Kuçi për "Gazeta Shqiptare".

STATISTIKAT

Të dhënat e fundit të INSTAT, për matjen e nivelit të jetesës treguan se pesha e shpenzimeve për arsim ishte 3.9% e totalit të shpenzimeve të familjeve shqiptare, një peshë gati katër herë më e lartë se e familjeve Europiane. Mesatarja e Bashkimit Europian është 1.1%, ndërsa një familje në rajon i kushton shumë më pak (në termin relativ ndaj shpenzi-

meve totale) që të shkollojë fëmijën. Serbia, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina e kanë këtë raport midis 0.6-0.7%, ndërsa në Kroaci arrijnë në 1.1%. Për familjet kushtiane shpenzimet për arsim kanë një peshë të konsiderueshme në totalin e shpenzimeve që ato bëjnë, me rreth 9.1% të totalit, duke u renditur pas shpenzimeve për ushqim, sipas INSTAT.

Pas Kukësit, qarku ku shpenzon më shumë për arsim është Përi, me 6.8% ndaj totalit. Më pas renditet kryeqyteti, Tirana me 5.2% të totalit të shpenzimeve për arsim dhe Lezha me të njëjtën peshë të shpenzimeve.

Me një diferencë të ngushtë nga mesatarja kombëtare renditet Korça me rreth 3.1% të totalit të shpenzimeve për arsim. Durrsakët dhe gjirokastritët shpenzuan për arsim përkatësisht 2.4 dhe 2.3% të totalit të shpenzimeve të tyre.

Studentët e rretheve i bashkohen protestës, bojkotohet mësimi

Studentëve të Tiranës i bashkuan edhe universitetet e Korçës, Durrësit dhe Elbasanit, të cilët po ashtu bojkotuan mësimin dhe dolën në rrugë. Edhe këta studentë kërkojnë heqjen e pagesës për kreditet e provimeve të mbartura, përgjysmim të tarifës dhe përmirësim të kushteve në konvikte. Një tjetër kërkesë është edhe përfaqësimi dhe dëgjimi i zërit të tyre në vendimmarrje. Pavarësisht kërkesave të studentëve për përgjysmim tarifë, ministria Nikolla iu ka bërë thirrje të rinjve dy ditë më parë që të njohin më shumë ligjin. "Ka ardhur koha që të gjithë të mësojnë të vërtetën se çfarë ka ndodhur me tarifaf. Nga 2009-2013, nuk po i referohem vitit 2005, se rritja është edhe më e thellë. Në 2013 - 2017 kemi rritje vetëm në vitin 2014 të tarifës maksimale. Kjo rritje nuk ka prekur gjithë programet e studimit, ka prekur vetëm shkencat e natyrës dhe gjuhët e huaja. Efekti financiar, 75 mln lekë. Ishte vendimmarrje në kohën e duhur, pasi në 2014 bëmë një ndërhyrje në arsimin e lartë, duke mos kuotuar më part time, i cili është një histori më vete. Ndaj nuk mund të lejojmë një gropë financiare tjetër. Një 5570 lekësh në vit, kjo është rritja, se sa fish është të gjithë i bëni vetë llogaritë. Dhe deri më sot në 4 vite, nuk kemi asnjë rritje tarifash studimi. Vendimmarrja nuk ka paraparë rritjen e tarifaf. Ligji i ri i jep qeverisë të drejtë vetëm për tarifë tavan, të tjerat janë kompetencë e fakulteteve", -theksoi ministria Nikolla.



STRATI Shoqëria përbërëse "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shifren në aneknd të pasurive të paluajshme:

"Apartment Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katin e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komuna Daç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillësar i anekndit është 19,516 Euro.

Anekndi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 10.12.2018.

Anekndi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbërëse "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

PROTESTAT REAGIMET

Kërkesat e studentëve, Rama nxjerr provat: Investim i masiv me qeverinë gjermane

Protestat studentore, Ilir Meta: Dialog, rinia aset i çmuar kombëtar Basha: Të rinjtë prishën rehatinë e bandës së hajdutëve

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta apeloj dje për zgjidhjen institucionale të shqetësimeve të studentëve dhe më shumë përpjekje për një arsim dhe edukim sa më cilësor, që garanton shanse të barabarta për të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre financiare. Z. Meta kërkoi nga autoritetet shtetërore që t'i konsiderojnë me prioritet kërkesat e studentëve, pasi sipas tij, të rinjtë janë aseti më i çmuar kombëtar. Duke vlerësuar situatën e krijuar, Meta u bën thirrje autoriteteve dhe institucioneve përgjegjëse të dëshmojnë ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë e duhur, në adresimin e çështjeve që shqetësojnë studentët, në përpunim me kuadrin ligjor dhe të frymës së dialogut, për një zgjidhje sa më të shpejtë dhe të drejtë në interesin më të mirë publik. "Duhet bërë më shumë përpjekje për një arsim dhe edukim sa më cilësor, që garanton shanse të barabarta për të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre financiare. Rinia është aseti ynë më i çmuar kombëtar, ndaj dhe kujdesi ndaj shqetësimeve dhe aspiratave të tyre duhet të jetë prioritet i të gjithëve, sidomos i institucioneve", deklaroi kreu i shtetit.

KRYEMINISTRI

Një nga tri pikat e studentëve që do t'i rikthejë sot sërish në protestë është përmirësimi i kushteve në konvikte. Por, kryeministri Rama përmes një postimi në 'FB' shprehet se qeveria e tij në bashkëpunim me qeverinë gjermane ka nisur si asnjëherë më parë një investim masiv për të ndryshuar rrënjësisht situatën e trashëguar të konvikteve. "Meqë po diskutohen këto ditë edhe kushtet e godinave për studentët, ja prova që kjo qeveri, si asnjë tjetër më



Presidenti i Republikës, Z. Ilir Meta

DEKLARATA



LUÇIANO BOÇI

Deputeti i PD, Luçiano Boçi ishte dje në protestën e studentëve të Elbasanit si pedagog dhe jo si përfaqësues politik. "Për 30 vitejam pedagog i këtij universiteti. Kam pasur një kërkesë nga studentët që unë të jem i pranishëm dhe i mbështes ata".



MESAZHI

"PDIU mbështet protestën e studentëve dhe deklaron se do të mbështesë çdo protestë të tyre, duke refuzuar çdo akt arrogancë e keqtrajtimi këtij brezi të mrekullueshëm të rinjsh. Gjithçka për të rinjtë. Dhjetori u kthye. Ky vend ka ende shpresë".



parë, ka nisur një investim masiv (18.8mln faza 1) në bashkëpunim me qeverinë gjermane, për të ndryshuar rrënjësisht situatën e tra-

Ligji, Tabaku: E keqja që ka kapluar universitetin

Deputetja e PD, Jorida Tabaku, e shikon problema tërësisht të ligjit të Arsimit të Lartë, i hartuar dhe miratuar tri vite më parë. Sipas saj, tarifat rriten çdo vit. Ajo përmendi se atëherë në Kuvend u përplasën dy grupe. "Qeveria e sotme që këndonte këngën e oligarkëve dhe hartuesve realë të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe opozita, që luftoi në krah të studentëve dhe pedagogëve. Asaj kohe ministri Nikolla dhe kryeministri Rama zotoheshin se nuk ka tarifa të larta, por ja ku jemi sot. Tarifat rriten për vit, universitetet publike rrënohen, ndërsa fitimtarët janë veç ata që e financuan gjoja reformën", tha z.Tabaku. Ajo akuzoi se: "Ministria sot luan kukafshehtin, ndërsa kryeministri e nxjerr atë për të testuar sjelljen e studentëve. E keqja që ka kapluar sot universitetet nis nga ky ligj dhe nga gjoja reforma. Asgjë nuk zgjidhet nëse ligji nuk rishikohet apo pezullohet. Asgjë nuk zgjidhet nëse pas katër pikave të studentëve nuk abrohet ligji plotësisht".



shëguar të konvikteve. Ndiqeni deri në fund, sepse nis si 3D, por vazhdon si realitet i prekshëm i kantierit të parë të këtij projekti", theksoi z.Rama. Ky reagim i kryeministrit vjen pak pas mbylljes së protestës së organizuar nga studentët, të cilët në katër pikat e kërkesave të tyre kishin edhe përmirësimin e kushteve të konvikteve. Për më shumë se 2 orë qindra studentë nga të


gjitha universitetet e Tiranës protestuan dje përpara Ministrisë së Arsimit. Me protestën e tyre u solidarizuan dhe Universiteti i Korçës, Durrësit, Elbasanit e Shkodrës.

LULZIM BASHA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi dje nga zona e "Astirit" në Tiranë ku po mbështet banorët që do t'u shemben shtëpitë, se protesta e mijëra studentëve ua prishin rehatinë

MONIKA KRYEMADHI

Kryetarja e LSI i kërkoi politikës të mësojë nga studentët. "Bravo! Ju meritoni të jetoni të lumtur në Shqipëri. Politika duhet të mësojë prej jush. Respekt dhe mirënjohje!", shprehet Kryemadhi.



Protesta e banorëve të "Astirit"

Vasili, Ramës: O budalla edhe Ajnshtajni ka ngel në provime

Kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili, iu kundërpërgjigj deklaratave të kryeministrit Rama për studentët, duke i kujtuar shkencëtarin Albert Ajnshtajni, i cili gjithashtu ka qenë mbetës në provime. "Kryeministri i çmendur dhe shkollëpak! Ky kryeministër idiot broçkullit turpet më të mëdha për studentët. Na thotë jo studentët mbetës kështu po ashtu, që gjoja nuk i paguan nga taksat për ta. O budalla kryeministër, mbetësit janë vetëm në turirin tënd demode. Sot ka vetëm studentët, që marrin apo nuk e marrin provimin e radhës. Po Ajnshtajni që ndryshoi botën, por ka mbetur në provime, çdo t'i thuash të shkollëpaku proverbial. Ridhënia e provimeve është një mundësi e re për t'u provuar për çdo student dhe s'mund të jetë objekt përcmimi dhe stigmatizimi, aq më shumë nga një sharlatan të dijes dhe shkencës si ti", u shpreh z.Vasili.



PETRO KOÇI

Zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi iu përgjigj z.Vasili për Ajnshtajnin, teksa tha se po të mbetesh në klasë, nuk do të thotë se do bëhesh gjeni. "Einstein vërtet ka mbetur në një rast, por kjo s'do të thotë që po të mbetesh në klasë bëhesh gjeni!", shkruan Koçi.

bandës së hajdutëve. Basha u pyet nëse opozita do të kishte një protestë më 8 Dhjetor, siç ka ndodhur vitet e shkuara, duke deklaruar se PD është në krah të qytetarëve për çdo protestë të tyre. "Ne kemi një vendim dhe vendimi është që kudo ku të protestohet, të jemi në krah të njerëzve. Nuk ka detyrë më të lartë që opozita, nuk kam unë detyrë më të rëndësishme, se sa të jem

në krah të këtyre njerëzve. Unë kam qenë krah tyre edhe kur nuk vinit ju, edhe kur kërcënohej një shtëpi për t'u shembur. Detyra jonë është të jemi pranë këtyre njerëzve. Kjo është një protestë qytetare. Studentët ia prishën rehatinë bandës së hajdutëve. Qytetarët do të protestojnë për të drejtat e tyre dhe ne do të jemi krah tyre", deklaroi z.Basha.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69-2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIFERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMIR SULA.

ÇMIMI 5.445.148, 8 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866.

Kreu i PD: "Victoria Invest", Rama Invest dhe Veliaj Invest, tre hajdutët e Unazës

Unaza e Re, Basha: Projekti duhet të kushtonte 10 herë më pak

"Rama do t'i nxjerrë banorët në mes të dimrit!"

Valentina Madani

Në ditën e 33-të të protestës, banorët e zonës së "Astirit" u mblohdën sërish mbrëmë pranë mbikalimit, duke bllokuar të dyja anët e rrugës. "Qeveri hajdute", "Poshtë qeveria", "Këtu vendosim ne" ishin thirrjet e përsëritura të tyre. Ata kërkuan dëmshpërblim për banesat e tyre, që u preken nga projekti i Unazës së Madhe. Paralelisht me protestën në Unazën e Madhe, në protestë dolën dhe edhe banorët e Shkozës, të cilët po ashtu kundërshtojnë prishjen e shtëpive të tyre. Ata u vendosën në rrugë, duke bllokuar qarkullimin e mjeteve. Edhe ata kërkuan dëmshpërblim për objektet që do të shemben. Pak ditë më parë, ata në shenjë proteste bllokuan jo vetëm rrugën, por edhe dogjën kabanë e mbeturinave.

MBËSHETJA

Opozita me në krye kreun Lulzim Basha ishin edhe mbrëmë në mbështetje të banorëve të zonës së "Astirit", por duke premtuar se PD do të jetë përherë në krah të qytetarëve. Z.Basha akuzoi se qeveria do t'i nxjerrë banorët nga shtëpitë në mes të dimrit. Ai tha se në Unazën e Re ka një aferë korruptive. "Edi Rama iu thotë këtyre të pasur, jeni futur në shtëpitë e tyre, i keni parë si i kanë shtëpitë këta, të ndërtuara me djersë dhe gjak. Pastaj shkoni dhe shikoni vilën e Surrelit, apartamentet dhe vilat e ministrave të Edi Ramës, të Gjijkurit, Ahmetajt, Ilir Bejas, Lindita Nikollës, Erion Vellajt, Saimir Tahirit. Këta janë njerëz të varfër. E bën për t'i përçarë banorët. Këtyre banorëve u thotë shpallur se i kanë prishur qetësinë hajdutit. Rëndësia e kësaj proteste është që për herë të parë njerëzit po e kuptojnë që kjo është një bandë, e cila ka një projekt dhe një politikë: grabitjen", theksoi z.Basha. Për kreun e opozitës, qëndresa e banorëve të Unazës e ka dhënë rezultatin, teksa paralajmëroi se beteja vazhdon. Basha iu përgjigj edhe njëherë akuzave të kryebashkiakut Veliaj lidhur me firmën "Victoria Invest". "Victoria Invest" është pjesë e vjedhjes bashkë me Edi Rama Invest dhe Erion Veliaj Invest. Kjo është e vërteta. Të vjedhë me "Victoria Invest" në një projekt që duhet të kushtonte 10 herë më pak, edhe të vjedhë lekët dhe të thotë pastaj është kompania e Lulit. Jo. Jo. "Victoria Invest", Edi Rama Invest dhe Erion Veliaj Invest janë tre hajdutët e kësaj afere kor-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe me banorët e "Astirit"

BANESAT

Z. Veliaj bëri të ditur se Bashkia e Tiranës ofron banesa sociale ose pagesën e qirasë së banesës për të gjithë ata që kanë ndërtuar pa leje dhe që preken nga gjurma e Unazës së Madhe.

AKUZA

Partia Demokratike ka akuzuar se z. Veliaj është takuar fshehëzazi me disa banorë në shoqërinë e tropojanëve dhe përfaqësues të Partisë Socialiste në zonë.

DEKLARATA

"Detyra jonë është të jemi pranë këtyre njerëzve. Kjo është një protestë qytetare, një kauzë qytetare. Ne do jemi në mbështetje të banorëve edhe kur është fjala për një shtëpi. Do jemi në krah të qytetarëve, të cilët protestojnë për të drejtat e tyre. Bashkimi është përgjigja e vetme për t'u përballur me këtë qeveri hajdute", tha kreu i PD-së.

Protesta, Berisha akuzo

Ramës: Po mashtrojnë studentët për tarifaf

Ish-kryeministri Sali Berisha u bëri dje thirrje shqiptarëve që të bashkohen me studentët në protestat e tyre. Z.Berisha sulmoi ashpër kryeministrin Edi Rama dhe ministrin Lindita Nikolla, ndërsa shtoi se ata po përpigën të mashtrojnë studentët. Sipas Berishës, qeveria është e tronditur dhe në panik për shkak të protestës së studentëve. Berisha akuzon se qeveria gënjen kur shprehjet se tarifaf e studimit i caktojnë dekanatet dhe universitetet. Teksa u bëri thirrje qytetarëve që t'i bashkohen protestës, Berisha shprehjet i bindur se studentët do të fitojnë. "Në të vërtetë tarifaf e pranimit të studentëve miratohen çdo vit nga Këshilli i Ministrave dhe konkretisht në vitin 2018 janë miratuar me vendimin nr. 288 dt. 21.5.2018 të firmosur nga vet Kallam Dëshaku. Në përgjigje të kësaj kërkesë plotësisht legjitime pasi tarifaf që paguajnë bazuar nga vendimi çnjerëzor i narkoqeverisë janë 4-15 herë më të larta se sa në vendet anëtarë të BE-së, kurse pesha e shpenzimeve që paguajnë në mesatare familjet për shkollimin e tyre, siç dëshmon grafiku i EUROSTAT-it, është rreth katër herë më e madhe se sa mesatarja e vendeve të BE dhe 5.5 herë më e madhe se në Serbi e Maqedoni dhe 6.5 herë më e madhe se në Bosnje. Këtyj trillimi të paskrupullit të Kallam Dëshakut dhe Ndrikul Viles, studentët grevistë iu përgjigjën nga sheshi i protestës me kërkesën legjitime: arsim publik falas!", shprehjet z.Berisha.

Kreu i bashkisë ulet në kafe me banorët e "Astirit"

Unaza e Re, Veliaj: Konsensus me banorët që projekti të mos bllokohet



het, qoftë në pjesën mbrapa ku nuk i prek autostrada, ose për ata që s'kanë asnjë letër në banesa sociale, si shumë familje që kanë pranuar", theksoi z.Veliaj. Kreu i bashkisë u bëri thirrje edhe ban-

DEKLARATA

Për të gjithë ata që e kuptojnë vlerën e shtetit, vlerën e qytetit, të familjes, vlerën e pronës dhe mund të gjejnë një të mesme të përbashkët, por edhe projekti të bëhet, por edhe prona të zhvillohet, qoftë në pjesën mbrapa ku nuk i prek autostrada, ose për ata që s'kanë asnjë letër në banesa sociale, si shumë familje që kanë pranuar", theksoi z.Veliaj.

ruptive bashkë me disa të tjerë, që kanë konto bankare sekrete dhe po bëhen gati të pastrojnë paratë e

veprës kriminale të vjedhjes dhe korrupsionit me konto sekrete bankare. Është qeveri hajdute, që duhet zm-

brapsur. Është një projekt që duhet rrezuar dhe pushet i duhet kthyer qytetarëve. Do jemi krah qyteta-

rëve. U bëj thirrje qytetarëve kudo që janë të ngrihen ndaj padrejtësisë", theksoi z.Basha.

Shoqëria perbarimorë JUSTITIA
Shoqëria perbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dyte, për shënjë e pasurisë së paluajtshme, për të cilat ka vene hipotekë NGB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji njesi me sip. 189 m2 nr pasurisë 5188hd-1, zk.8350 vol 28 tq146 RRP.Myezaqari TIRANË në pronësi të z.Ajvan Rahmi BAHOLLI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 179.760 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) EUR
Lloji apartamenti sip.132m2 zk.8350 nr.pas.5188hd-1-19 vol 18 tq.185 Rruga Prokop Mbyezaqari TIRANË në pronësi të z.Ajvan Rahmi BAHOLLI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 73.920 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) EUR
Ankandi zhvillohet në datën 08.01.2019, në orarim të ditës zyrtar, ora 16:30 në zyrën e perbarimit gjyqësor me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tirane, Shqipëri, web- www.studijostitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria perbarimorë JUSTITIA
Shoqëria perbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dyte, për shënjë e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipotekë NGB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
Lloji i pasurisë Ares-Truall (magazine dy kate) me sip. arë 3000 m2 / rruall 1661/ndritësë 234,3, me nr.pasurisë 589 vol 8 fq76, zk.1475, Derven, KRULLË në pronësi të Haki Ahmet MAVRICI
Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 67.200 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) EUR
Ankandi zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e perbarimit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studijostitia.com, tel. +355 4 2270890

BOJKOTI MANDATET

Spartak Braho është deputeti që fitoi më shumë, Edi Paloka më pak

Zbulohen honorarët dhe dietat, ja sa fituan deputetët në dy muaj 2 milionë lekë të tjera veç pagës

Kuvendi ka publikuar të dhënat për të ardhurat e deputetëve nga paga dhe përfitimet e tjera për muajin shtator dhe tetor të këtij viti. Por, ndërsa paga e një deputeti bruto kap vlerën 156 mijë lekëve dhe nuk ka ndryshim nga muaji në muaj, ajo që mund të konsiderohet një fitim akoma më i madh për deputetët janë të ardhurat që vijnë nga përfitimet e tjera që sjell të qenurit deputet. Kështu, për shumë të zgjedhur të Kuvendit të Shqipërisë të ardhurat që i jepen një deputeti si pagesë për telefonin, karburantin, dietat, honoraret dhe qiratë e shtëpive apo pagesa e hotelit shkon në një muaj deri në mbi 200 mijë lekë të reja. Një parlamentar mund të përfitojë të ardhura deri në 40 mijë lekë në muaj për shpenzime karburanti, 17 mijë lekë për shpenzime telefoni, 75 mijë lekë si pagesë për dietat, deri në 22 mijë lekë nga pagesat për pjesëmarrje në komisione dhe deri në 40 mijë lekë si pagesë për qiranë apo fjetjen në hotel, ku ai nuk e ka vendbanimin në Tiranë.



Gjatë një seance parlamentare

PËRFITIMET

Një parlamentar mund të përfitojë të ardhura deri në 40 mijë lekë në muaj për shpenzime karburanti, 17 mijë lekë për shpenzime telefoni, 75 mijë lekë si pagesë për dietat, deri në 22 mijë lekë nga pagesat për pjesëmarrje në komisione dhe deri në 40 mijë lekë si pagesë për qiranë apo fjetjen në hotel, ku ai nuk e ka vendbanimin në Tiranë.

Berisha dhe Basha përfituan më pak të ardhura në shtator dhe tetor

Bojkoti deputetëve të opozitës u kushtuar financiarisht jo vetëm sa i përket mbajtjes së pagës, por edhe sa u përket përfitimeve të tjera që siguron një deputet si i zgjedhur i popullit. Dhe deputeti opozitar që ka përfituar më pak nga të gjithë është Edi Paloka me vetëm 90 mijë lekë në dy muaj ose 45 mijë lekë në muaj. Menjëherë pas tij renditet ish-kryeministri Sali Berisha, i cili siç rezultojn në tabelën e publikuar nga Kuvendi ka marrë vetëm 94 mijë lekë në dy muaj ose 47 mijë lekë në muaj. Po kaq ka përfituar edhe kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Pastaj, me radhë vijnë deputetë të tjerë demokratë si Halim



Kosova, Floida Kërpaçi, Agron Shehaj etj. I vetmi deputet socialist që është në listën e dhjetë deputetëve që kanë fituar më pak është

DEPUTETËT QË KANË FITUAR MË PAK

- Edi Paloka - 90048 lekë
- Sali Berisha - 94032 lekë
- Lulzim Basha 94032 lekë
- Halim Kosova - 94032 lekë
- Floida Kërpaçi - 108870 lekë
- Agron Shehaj - 114000 lekë
- Rahman Rrahja - 119000
- Dashamir Shehi - 131657 lekë
- Gent Strazimiri - 133357 lekë
- Florian Mima - 134053 lekë

Rahman Rrahja, i cili u bë i njohur për publikun për shkak të implikimit të djalit të tij në çështjen "Xhisiela".

KUSH FITOI MË SHUMË

Kampion për këtë kategori të ardhurash për këto dy muaj të mara së bashku është deputeti socialist Spartak Braho, i cili në total ka arritur të fusë në "xhep" plotë 415 mijë lekë të reja për dy muaj, ose afërsisht 207 mijë lekë të reja në muaj. Natyrisht që në të ardhurat e kësaj kategorie për një deputet ndikon direkt si largësia e zonës së tij zgjedhore nga Tirana, ashtu edhe korrektësia e tij për të ndjekur çdo aktivitet legjislativ, përfshi pjesëmarrjen në komisione. Pas Brahos, parlamentari që ka mundur të sigurojë më shumë përfitime është Edmond Leka. Ai ka fituar plotë 400 mijë lekë në dy muaj ose 200 mijë në muaj. E treta në radhë e të zgjedhurve që kanë përfituar më shumë të ardhura renditet deputetja Elena Xhixha me 371 mijë lekë në dy muaj ose afro 185 mijë lekë në muaj. Me radhë vijnë më pas shumica e de-

puteteve femra, të cilat duket se janë edhe më të rregulltat në frekuencimin e aktivitetit parlamentar. Më konkretisht, Tatjana Nurçe ka fituar 364 mijë lekë në dy muaj, Izmira Ulqinaku 362 mijë lekë në dy muaj, Luan Harusha 358 mijë lekë në dy muaj, Evis Kushi 357 mijë lekë në dy muaj, Adelina Rista 348 mijë lekë në dy muaj dhe për të vazhduar më pas

me disa deputetë të tjerë, që kanë arritur të marrin mbi 300 mijë lekë në dy muaj ose afro 150 mijë lekë në muaj.

RUÇI

Natyrisht që në listën e atyre që përfitojnë më shumë mungojnë ndoshta ata që kanë edhe më shumë të ardhura, siç mund të jenë drejtuesit e Kuvendit apo ministrat. Kështu, në këtë tabelë kryetari i Kuvendit,

Gramoz Ruçi rezultojn më vetëm 111 mijë lekë të ardhura për këto dy muaj, por atij nuk i llogariten në këtë pjesë telefoni dhe karburanti, të cilat i ka pa limit. Po ashtu, në njëjtat kushte është edhe nënkryetarija e Kuvendit, Vasilika Hysi e cila për shkak të funksionit si nënkryetare nuk janë llogaritur leket që përfiton si pagesë për telefonin dhe karburantin.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

JA KUSH JANË DEPUTETËT QË KANË PËRFITUAR MË SHUMË NË DY MUAJ

- SPARTAK BRAHO 415803 LEKË
- EDMOND LEKA - 406500 LEKË
- ELENA XHIXHA - 371154 LEKË
- TATJANA NURÇE - 364500 LEKË
- IZMIRA ULQINAKU - 362570 LEKË
- XHEVIT BUSHAJ - 360500 LEKË
- LUAN HARUSHA - 358500 LEKË
- EVIS KUSHI - 357154 LEKË
- FADIL NASUFI 352700 LEKË
- ADELINA RISTA - 348500 LEKË
- ILIR PENDAVINJI - 348500 LEKË
- NARD NDOKA - 334500 LEKË
- NADIRE MEÇORAPAJ - 334500 LEKË
- EDLIRA BODE - 319500 LEKË
- ANDREA MARTO - 312500 LEKË
- ANTONETA DHIMA - 304500 LEKË
- VILMA BELLO - 304500 LEKË
- ILIR XHAKOLLË - 298500 LEKË
- ALMIRA XHEMBULLA - 288500 LEKË
- JURGYS ÇYRBJA - 282928 LEKË
- ILIR DRAXHI - 281500 LEKË
- DRITAN BICI - 281000 LEKË
- BUJAR ÇELA - 280500 LEKË
- ROLAND XHELILAJ - 276500 LEKË
- LUAN DUZHA - 269500 LEKË
- KLODIANA SPAHIU - 266657 LEKË
- ARBEN KAMANI - 265000 LEKË
- AGRON ÇELA - 264500 LEKË
- VANGJEL DULE - 264500 LEKË
- VANGJEL TAVO - 264500 LEKË
- LORENC LUKA 264500 LEKË
- ROMEO GURAKUQI 264350 LEKË
- EDNOR SHAMETI - 253500 LEKË
- ALEKT HYSINI - 233000 LEKË
- BASHKIM FINO - 233000 LEKË
- XHEMAL QEFALIAJ - 227282 LEKË
- ARBEN PËLLUMBI - 219400 LEKË
- BESNIK BARAJ - 217500 LEKË
- ROBERT BITRI - 216000 LEKË
- PJERIN NDREU - 211300 LEKË
- BLERINA GJYLHAMETI - 203282 LEKË
- ERVIN BUSHATI - 203282 LEKË



Edi Rama: Mbi 60 mijë nëpunës përfitojnë rritje page

Kryeministri Edi Rama ka publikuar dje të dhënat e detajuara mbi nëpunësit që përfitojnë nga rritja e pagave, që do të ndodhë që nga 1 prilli i vitit të ardhshëm. Përmes një videoje ilustruese të publikuar në rrjetet sociale, kreu i qeverisë thekson se 60 mijë nëpunës do të kenë mundësi të përfitojnë një rritje page nga 7 deri në 20 për qind. Buxheti 2019 do të financojë mbi 2 miliardë lekë për rritjen e pagave për mbi 60 mijë të punësuar, nga të cilat 1 miliard lekë për rritjen e pagave në shëndetësi, ku 4650 mjekë, 13 765 infermierë, laborantë, ndihmësmjekë përfitojnë rritje pagë mesatarisht me 7%. Ndërkohë që 1.37 miliardë lekë shkojnë për rritjen e pagave të 35 873 mësues e staf mësuesor që përfitojnë rritje page po 7%. Sipas kryeministrit, në vitin 2019 fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 9.1% në krahasim me vitin 2018, ndërsa do të punësohen 438 edukatorë më shumë se në vitin 2018, në 32 bashki!

Deputetët e PD dhe LSI kanë qenë për herë të fundit në parlament më 19 korrik

Opozita rrezikon mandatet, nëse skthehet në Kuvend brenda dhjetorit

Berisha dhe Basha, mes 28 deputetëve që rrezikojnë

Afro gjysma e deputeteve të opozitës mund të humbasin mandatin, nëse brenda dhjetorit nuk shkojnë qoftë edhe një herë të vetme në parlament. Kjo, pasi ata kanë thuhet 5 muaj plot që bojkotojnë çdo aktivitet parlamentar dhe për rrjedhojë rrezikojnë të preken nga përcaktimi që bën Kushtetuta që mandati i deputetit mbaron apo është i pavlefshëm kur mungon pa arsye për 6 muaj resht në Kuvend. Janë plot 28 deputetë të PD, LSI e partive të tjera aleate, të cilët për herë të fundit kanë qenë në parlament në 19 korrik e pikërisht në 19 janar mbushin 6 muaj që ata mungojnë në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo, duke iu referuar pikërisht procesverbalet të Kuvendit të Shqipërisë për pjesëmarrjen në seanca plenare apo në komisionet parlamentare. Ndaj, këta deputetë që të mos preken nga përcaktimet që bën Kushtetuta duhet të ishin të pranishëm brenda datës 19 janar. Por në këtë rast, deputetët demokratë nuk i favorizon mbyllja e këtij sesioni parlamentar në dhjetor dhe nisja e sesionit të ri në janar. Kjo, pasi Rregullorja e Kuvendit thotë se sesioni i parë vjetor i punimeve të Kuvendit nis të hënën e tretë të janarit. Çka do të thotë se sesioni i ri i vitit 2019 nis më 21 janar, pra gati 3 ditë pasi



Opozita e bashkuar gjatë një takimi

deputetët opozitës mbushin plot 6 muaj që nuk shkojnë në Kuvend. Por, se duket më i rrezikuar është nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, i cili pjesëmarrjen e fundit në Kuvend e ka pasur më 5 korrik. Gjithsesi, edhe ai nisur nga fakti se Kuvendi është pushim, do duhet që të rikthehet në Kuvend brenda dhjetorit, ashtu si edhe kolegët e tjerë në mënyrë që të mos i digjet mandati. Ndër shumë deputetë, në rrezik për djeje mandate janë edhe drejtuesit dhe figurat kryesore të PD-së dhe LSI-së, si Lulzim Basha, Sali Berisha dhe drejtuesja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Por mes deputetëve, ka një sërë syresh të cilëve nuk i cenohet mandati, pasi kanë qenë pjesë e komisioneve parlamentare apo të Këshillit të Legjislacionit, siç ishte rasti i kësaj të mërkure të deputetëve Oerd Bylykbashi, Enkeljed Alibeaj, Gent Strazimiri, Nasip Naço, Edmond Haxhinasto dhe Silva Caka. Ndërkohë që koha ecën, opozita duket se nuk është ende e gatshme për të marrë një vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje. Kështu, kryetari i demokratëve, Lulzim Basha ka anashkaluar diskutimin për mandatet, ndërsa ka folur gjithmonë për krizë politike, e cila merr fund me miratimin e vetingut në politikë. Ndërkohë që aleatja e tij, Monika Kryemadhi vetëm pak ditë më parë deklaroi se opozita nuk do i djeje mandatet. "Unë mandatin e kam marrë me gjak. Nuk e lë Edi Ramën që të bëjë ç'të dojë. Nuk është problemi te mandati im. Por hyj prapë unë, i

fus një të votuar dhe dal prapë. Po ashtu nuk quhet bojkot. Ne jemi me shqiptarët. Mandati është i imi dhe jo i Edi Ramës, nuk ma heq dot mandatin ai mua. E djeç unë atë me kuç e me maç, me gjithë kriminelët", u shpreh Kryemadhi gjatë një interviste televizive.

DEPUTETËT QË U DIGJET MANDATI

1. AGRON ÇELA
2. ALDO BUMÇI
3. ANDON FRROKAJ
4. ASTRIT VELIAJ
5. BARDH SPAHIA
6. DASHAMIR SHEHI
7. EDI PALOKA
8. EDMOND SPAHO
9. FATBARDHA KADIU
10. FLAMUR NOKA
11. GENC POLLO
12. GRIDA DUMA
13. HALIM KOSOVA
14. LINDITA METALIAJ
15. LUAN BACI
16. LUÇIANO BOÇI
17. LULZIM BASHA
18. MONIKA KRYEMADHI
19. MYSLYM MURRIZI
20. NADIRE MEÇORAPAJ
21. ORJOLA PAMPURI
22. ROMEO GURAKUQI
23. RUDINA HAJDARI
24. SALI BERISHA
25. TRITAN SHEHU
26. VALENTINA DUKA
27. VANGJEL DULE
28. XHEMAL GJUNKSHI

Kokëdhima: OSBE të mos bëjë kompromis, reformë zgjedhore evropiane

Partitë joparlamentare zhvilluan një tryezë diskuti mi për reformën zgjedhore. Zef Bushati prezantoi një projektrezolutë me disa kërkesa për ndryshime urgjente në Kodin Zgjedhor, pasi reforma zgjedhore është kushti kryesor për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Përfaqësues të partive të joparlamentare si dhe studiues të zgjedhjeve në Shqipëri bënë të ditur se sistemi aktual që kemi po diskriminon partitë e reja dhe nuk përfaqëson vullnetin e popullit. "Liria buron nga ligjet", në këtë parim e bazoi fjalën e tij kreu i partisë "Zgjidhja" në tryezën e 21 partive për reformën zgjedhore. Ai tha ndër të tjera, se PS-PD e rrëzuan sovranitetin e popullit dhe nuk duan reformë zgjedhore. "Leadershipi i Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike e kanë nxjerrë tepër këtë popull, prandaj dhe po e dëbojnë dita-ditës. Mendojnë se ky popull nuk i meriton liritë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur", tha Kokëdhima. Ai akuzoi PS-së dhe PD-në se nuk kanë vullnet për të bërë reformë zgjedhore, ndaj i bëri thirrje edhe faktorit ndërkombëtar që të mos mashtrohet prej tyre. "Ata kërkojnë të mashtrjnë si opinionin e brendshëm, edhe faktorin ndërkombëtar. Duan të paraqiten sikur gjoja po bëjnë reformë zgjedhore. Ne nuk do ta lejojmë këtë mashtrim! Zgjedhjet do të dalin nga thonjtë e PD-së dhe PS-së, duan apo s'duan ato. Do të dalin edhe sikur ato të bëjnë kompromise me diplomatë të huaj në Tiranë. Kjo nuk do të ndodhë. Ne nuk do të pajtohemi me këto çështje. Ato do t'i lëshojnë zgjedhjet me hir ose me pahir dhe populli shqiptar do të bëhet sovran në tokën e vet dhe në vendin e vet!", tha Kokëdhima. Në fund, ky takim i kryerëve të partive të vogla miratoi edhe një rezolutë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 14,760,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 28 Dhjetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ngjarja në gusht të vitit 2005, kosovari u dënua me 20 vite burg në mungesë

Lul Berisha përballët në gjyq me atentatorin Ahmet Ajeti nga Kosova

TIRANË

Lulzim Berisha është përballur dje në procesin gjyqësor që po zhvillohet në Gjykatën e Krimeve të Rënda me personin që vite më parë ka tentuar ta vrasë. I shoqëruar nga avokati mbrojtës, Detar Hysi, Lulzim Berisha u paraqit në sallën e gjyqit në procesin ndaj 35-vjeçarit Ahmet Ajeti, i akuzuar si organizator i atentatit ndaj tij. Ngjarje kjo e ndodhur tri vite më parë. Në seancën gjyqësore të radhës, Berisha nuk ka pranuar të dëshmojë me pretendimin se vjen si i dëmtuar në proces. Ahmet Ajeti akuzohet se më 30 gusht të vitit 2005 ka bërë një atentat për vrasjen e Lulzim Berishës. Ajeti është dënuar në mungesë me 20 vjet burg për tentativë vrasjeje, ndërsa u ekstradua nga Liptani i Kosovës, në Shqipëri 4 muaj më parë. Pas ekstradimit, ai kërkoi rihapjen e çështjes dhe rishqyrtimin e dosjes në prani të tij. Proceset gjyqësore kanë dështuar disa herë te Krime të Rënda, për shkak të mosparaqitjes së Lulzim Berishës. Sipas motrës së tij, ai nuk ishte në Shqipëri, por referuar të dhënave të sistemit TIMS, Berisha rezultonte brenda vendit.

ATENTATI

Më 30 gusht të vitit 2005, Ahmet Ajeti dhe O.K., të porositor nga shtetasit E.D. dhe A.C. kanë shkuar nga Tirana në Durrës për të vrarë Lul Berishën. Para se të kryejë atentati në afërsi



Ahmet Ajeti



Lul Berisha

EKSTRADIMI

Ahmet Ajeti u ekstradua nga Interpol Tirana më 20 korrik nga Prishtina në Rinas dhe nga ajo ditë mbahet i izoluar në qelitë e burgut 313 në Tiranë. Dyshohet se ekzekutimi e Lulzim Berishës, ai do ta bënte për llogari të grupeve rivale, të cilët një dekadë më parë përplaseshin mes tyre. Vetë Lulzim Berishia kreu disa vite burg për akuzat e grupit të strukturuar kriminal, ndërsa u lirua me kusht nga drejtësia shqiptare.

të lokalit ku ndodhej Berisha, kosovari Ahmet Ajeti është konfliktuar me disa persona të panjohur dhe në grindje e sipër ka nxjerrë

pistoletën, ku dhe është vetë-plagosur. Ajeti ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana më 07.03.2016, pasi Gjykata e Sh-

kallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin nr. 01 datë 16.01.2012, e ka dënuar me 20 vjet burg për veprat penale: "Vrasje me

paramendim" dhe "Armëmbajtje pa leje". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Policinë e Kosovës, u bë i mundur arrestimi i tij në Kosovë, duke u finalizuar me ekstradimin e tij drejt vendit tonë. Ahmet Ajeti nuk është një emër i panjohur për drejtësinë shqiptare, pasi ai ka qenë pjesë e bandës së Endrit Dokles e Adriatik Colit. Pretendohet se është paguar me 80 mijë euro në vitin 2005 për të vrarë Lulzim Berishën.

SHKURT

Përplasen automjetet, 3 të plagosur, mes tyre një 5-vjeçar

ELBASAN - Një aksident me 3 persona të plagosur, mes të cilëve një fëmijë 5 vjeç ndodhi mbrëmë në aksin rrugor Elbasan-Tiranë, në afërsi të fshatit Mamël. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se mjeti me targa EL8982 B, me drejtues shtetasin A.Xh., është përplasur me mjetin me targa TR1388U me drejtues shtetasin B.M. Si pasojë e aksidentit janë dëmtuar 3 shtetas, të cilët ishin pasagjerë në mjetin me targa EL 8982 B. Konkretisht janë plagosur shtetasit me inicialet: J.M., 27 vjeç; L.D., 20 vjeç dhe K.Gj., 5 vjeç, banues në fshatin Katund i Ri. Ata janë transportuar në Spitalin e Elbasanit për mjekim, ndërsa ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e shkakut të aksidentit.

Plagosi me thikë fqinjin, kapet studenti 23-vjeçar

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka arrestuar dhe autorin e dyshuar të plagosjes me thikë të një 36-vjeçari, ngjarje kjo e ndodhur pasditen e së mërkurës në lagjen "Shënkolli" të këtij qyteti. Sipas bluve, autori i ngjarjes është 23-vjeçari Lorenc Luta, student në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Durrës. Hetuesit e çështjes punuan se ngjarja ku mbeti i plagosur Alfred Shqau (fqinji i të riut) ka ndodhur për motive të dobëta. Aktualisht 36-vjeçari ndodhet jashtë rrezikut për jetën në Spitalin e Elbasanit. Ndërkaq, materialet ndaj autorit të krimit, Lorenc Huta, i janë përcjellë Prokurorisë së Elbasanit për hetime të mëtejshme. Pritet që gjykata e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj tij.

Zhduket 56-vjeçarja familjarët, apel për ndihmë

FIER - Një 56-vjeçare nga Fieri është zhdukur dy ditë më parë pa asnjë gjurmë. Mësohet se Liljana Tafa nga fshati Zhupan ka humbur kontaktet me familjarët që në orën e para të mëngjesit të së mërkurës. 56-vjeçarja në momentin që është larguar nga banesa ka pasur veshur bluzë rozë me jelek gri si dhe tuta të zeza. Familjarët kanë denoncuar në polici për zhdukjen e saj si dhe kanë kontrolluar në spital dhe në morgun e Fierit. Ata bëjnë apel që kush mund ta ketë parë, të kontaktojë në numrin e telefonit 0682195608, pasi janë duke kërkuar intensivisht në të gjithë territorin e Bashkisë së Fierit.

Ylli Gjinika, i dënuar për trafik droge në Greqi

Përfundon në pranga 42-vjeçari i shpallur në kërkim, dyshohet si autor i 8 vjedhjeve

SARANDË - Një 42-vjeçar i shpallur në kërkim dhe i dyshuar si autor i 8 vjedhjeve është vënë në pranga nga policia e Sarandës. Bëhet fjalë për shtetasin Ylli Gjinika, banues në fshatin Çukë. Mësohet se Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, më datë 28.11.2018, ka caktuar ndaj tij masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprën penale "Vjedhja". Nga hetimet e kryera dyshohet se i riu është autor i 8 vjedhjeve dhe konkretisht: Më datë 25.09.2018 është vjedhur banesa e shtetasit B.C. Më datë 02.07.2018 është vjedhur banesa e shtetasit Q.R.. Më datë 31.07.2018 është vjedhur banesa e shtetasit K.P. Më datë 08.06.2018 është vjedhur banesa e shtetasit K.L.. Më datë 12.06.2018 është vjedhur banesa e shtetasit



T.S. Më datë 24.06.2018 është vjedhur banesa e shtetasit P.T. Më datë 06.03.2018 është vjedhur banesa e shtetasit R.R. dhe me datë 23.03.2018 është vjedhur banesa e shtetasit M.O.. Të gjitha këto vjedhje kanë ndodhur në fshatin Çukë të Sarandës. Nga bastisjet e kryera në banesat e sipërpërmendura ka rezultuar se Gjinika ka vjedhur

kryesisht orendi shtëpiake. Policia e Sarandës ka kryer një punë të gjerë hetimore për dokumentimin e veprave të këtij shtetas, i cili rezultoi i dënuar edhe më parë në Shqipëri për vjedhje dhe në Greqi për trafik lëndësh narkotike. 42-vjeçari njihet edhe me emrin Ilija Gjinika dhe është përdorues i lëndëve narkotike.



Trafiku i drogës nga Amerika drejt Europës, shqiptarët pjesë e grupit "Ndragheta"

ITALI - Pas hetimeve që zgjatën dy vite, të mërkurën u bë i mundur arrestimi i 90 personave, të cilët rezultojnë të jenë pjesë e mafies famëkeqe "Ndragheta". Ndërkaq, prokurori kombëtar i mafies italiane, Federico Cafiero de Raho ka dhënë detaje të reja, të cilat implikojnë edhe shtetas shqiptarë në grupin e trafikut të drogës. Duke iu përgjigjur interesit të medias italiane, prokurori shprehet se ky grup ka përdorur porte të rëndësishme për të kaluar sasi të madhe kokainës nga Amerika Jugore drejt Evropës. Disa nga pikat strategjike që përdorte grupi mafioz "Ndragheta" siç shprehet De Raho ishin: Porti Antwerp në Belgjikë, Roterdami, Xhenoa, Livorno, Napoli dhe Salerno. Substanca narkotike që vjen nga portet e Evropës Veriore u dërgua në Milano, por edhe në Emilia-Romagna dhe në Kalabri. Gjithashtu, raportohet se marrëdhënia e shqiptarëve me një grup kriminal nga Turqia ka qenë shumë intensiv në trafikun e drogës dhe se ata kanë bashkëpunuar edhe me pjesëtarët e grupit famëkeq "Ndragheta".

Biznesmeni merret në pyetje për 1 orë për çështjen e ish-hotel "Vollgës"

Hetim për pastrim parash, Ylvi Beqja dëshmon në prokurori kundër Shullazit

TIRANË

Përplasja mes Emiljano Shullazit dhe biznesmenit Ylvi Beqja është transferuar nga Krimet e Rënda në Prokurorinë e Tiranës. Dëshmitari i drejtësisë ka mbërritur dje në organin e akuzës së kryeqytetit, kësaj here për të dëshmuar në kuadër të një hetimi të ri ndaj Shullazit. Pas vendimit të dhënë për Shullazin dhe bashkëpunëtorët e tij, për të cilët gjykata caktoi dënimi total me 55 vite burg. Prokuroria e Tiranës po vazhdon hetimet për këtë grup, në lidhje me akuzën e pastrimit të parave. Me ndryshimet e reja ligjore janë prokuroritë e rretheve, që kryejnë hetime për pastrim parash për personat e përfshirë në krim të organizuar. Dosja më e bujshme që ka në dorë është ndaj Emiljano Shullazit dhe personi i parë i paraqitur për të dhënë dëshmi është biznesmeni Ylvi Beqja, i cili



Banda "Shullazi" në sallën e gjyqit

mban statusin e të penduarit dhe për këtë arsye Beqja shoqërohej në prokurori me forca speciale. Gjithçka, lidhet me çështjen e ish-hotel "Vollgës" në Durrës, pronë e cila po mbahet nën sekuestro paraprake, pasi ka dy-

shime të forta se është regjistruar në Hipotekën e Durrësit në kundërshtim me ligjin. Referuar dokumentacionit, i dyshuari Shullazi zotëron 30 për qind të kësaj prone, e cila shërbeu si shkak që biznesmeni Ylvi Beq-

ja t'i paguajë nën kërcënim grupit kriminal në formën e gjobës shumë prej 500 mijë eurosh. Krahas personazhit të shumëpërfolur, nën hetim për pastrim parash është edhe vetë biznesmeni Ylvi Beqja, dëshmia e të cilit ishte prova vendimtare për dënimin e Shullazit dhe katër të pandehurve të tjerë. Për vite me radhë për pronësinë e hotel "Vollgës" u zhvilluan disa procese gjyqësore, mes kompanisë "Saudi Brothers" dhe shtetasit Zamir Hasa. Në finale, prona, vlera e të cilës shkon mijëra euro, u regjistrua në Hipotekën e Durrësit në emër të kompanisë "Saudi Brothers". Ylvi Beqja pati deklaruar se e kontaktoi Shullazin për t'i dhënë ndihmë për regjistrimin e kësaj prone dhe në këmbim do t'i jepte 20 për qind të saj. Por, kur tentoi t'ia shiste një personi tjetër, Emiljano Shullazi bashkë me miqtë e tij kërkuan 30 për qind të sipërfaqes dhe një gjobë në vlerën e gjysmë milionit euro.



Armë me postë drejt Anglisë, Krimet e Rënda dënojnë me 8 vjet burg Saimir Çullhajn

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka dënuar me 8 vite burg Saimir Çullhajn, i akuzuar për trafik ndërkombëtar armësh. Ndonëse prokuroria kërkoi dënimin me 12 vjet heqje lirie, 33-vjeçari nga Shijaku u dënu me 8 vjet falë kërkesës për gjykim të shkurtuar Çullhajn u arrestua me 23 gusht të vitit të kaluar, pasi pohohet se ka bërë dërgimin e tri pakove me një prej agjencive të dërgesave postare, të cilat janë konstatuar gjatë skanimit në Aeroportin "Nënë Tereza". Në kuadër të procedimit penal të nisur për këtë ngjarje është bërë e mundur të dokumentohet veprimtaria kriminale e shtetasve të sipërpërmendur, të cilët në datë 23.08.2017 rreth orës 18:00 kanë bërë dërgimin e tre pakove me një prej agjencive të dërgesave postare, të cilat janë konstatuar gjatë skanimit në Aeroportin "Nënë Tereza". Brenda pakove janë konstatuar tri armë zjarri automatik model 56, të çmontuara. Paket kishin si destinacion Mbretërinë e Bashkuar, sgaroi policia ditën e arrestimit. Në lidhje me këtë ngjarje u shpall në kërkim edhe 47-vjeçari Neritan Farjan, nga Durrësi, i cili dyshohet se është bashkëpunëtor i Çullhajt. Policia e arrestoi Saimir Çullhajn, pasi tek armët u gjenden gjurmët e tij të gishtave, ndërsa vetë ai e ka mohuar përfshirjen e tij në këtë rrjet, duke deklaruar se nuk e dinte se çfarë kishte brenda në pako dhe se po niste një dërgesë tek miku i tij në Angli.



REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit":

1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- d. Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- e. Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- b. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- e. Të ketë njohuri bazë për panelin e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

KËRKESA TË POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME PËR VENDET VAKANTE "SPECIALIST IT" DHE "PËRKTHYES"

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 12 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Rudina Jasini: Juristët e ardhshëm duhet të ndryshojnë diçka në shoqëri

Pedagogia e Oksfordit te "Luarasi": Kërkoni gjithmonë të drejtën!

"Studentë të motivuar për të avancuar në fushën e dijes"

Voltiza Duro

Ditën e djeshme universiteti "Luarasi" priti në auditorin e tij, avokaten e njohur shqiptare, aktualisht studiuese dhe pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oksfordit, Rudina Jasini. Kjoë fundit është një ndër emrat më të njohur për sa u përket shumë çështjeve penale të së drejtës ndërkombëtare. Ekspertja e fushës së drejtësisë zgjodhi pikërisht universitetin "Luarasi" për të dhënë leksionin e saj të parë në vendin e origjinës. Jasini ka qenë pjesë e grupit të avokatëve në mbrojtje të kryeministrit Ramush Haradinaj në gjykatën ndërkombëtare në Hagë.

MESAZHI

Studentët e jurisprudence në universitetin "Luarasi" shumë shpejt do të jenë avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë. Pedagogia shqiptare e Oksfordit iu sugjeron atyre të mos reshtin duke kërkuar të drejtat e tyre. "Ishte një kënaqësi shumë e madhe për mua të mbaja leksionin e parë në Shqipëri apo para studentëve. Kam pasur mundësinë të mbaj ligjërata të tjera edhe në vende të ndryshme të botës. Besoj se kurioziteti, interesi apo edhe dëshira e motivimi që këta studentë kanë për të avancuar në fushën e dijes, ishte ajo që mua më ka bërë më shumë përshtypje në universitetin Luarasi", - thotë Jasini.



Dje gjatë leksionit të mbajtur në universitetin "Luarasi" nga pedagogia e Oksfordit, Rudina Jasini



RUDINA JASINI

PËRSHTYPJET

"Ishte një kënaqësi shumë e madhe për mua të mbaja leksionin e parë në Shqipëri apo para studentëve. Besoj se kurioziteti, interesi apo edhe dëshira e motivimi që këta studentë kanë për të avancuar në fushën e dijes, ishte ajo që mua më ka bërë më shumë përshtypje në universitetin "Luarasi", - thotë Jasini.



si", - thotë Jasini.

LEKSIONI

Kontributi i studiueses Jasini në fushën e jurisprudence ndërkombëtare është i jashtëzakonshëm dhe mbresëlënës. Por, a është e gatshme ajo të japë ekspertizën e saj të vyer

në fushën e së drejtës penale apo kushtetuese në Shqipëri? "E para njëherë, për të studiuar drejtësi kërkon mbi të gjitha një aspiratë për të ndryshuar diçka në shoqëri, për të avancuar dhe përmirësuar sistemin e drejtësisë. Do të

thosha që shumë studentë shqiptarë duhet të aspirojnë për të drejtën. Nuk ka kuptim të studiosh vetëm për t'u bërë një jurist i ardhshëm, ajo që ka rëndësi është të dish të vësh në punë dijen tënde për të avancuar shtetin e së

drejtës", - thekson pedagogia e Oksfordit. Gjatë leksionit, Rudina Jasini iu tha studentëve se arrijtjet e saj profesionale i ka falë gërshtimit të pasionit me vullnetin e fortë, si dhe falë etikës së punës.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Zbulohen këngët më të pëlqyera nga publiku, ja cilat kryesojnë listën

Ethet e garës në "Kënga Magjike", Flori Mumajesi pretendent për çmimin e madh

"Plas" është kënga e të gjithë atyre që dashurojnë vërtetë

Egla Xhemali

Kënga Magjike" ka nisur plot surpriza. Nën drejtimin e moderatorit të njohur Ardit Gjebrea dhe dy bukurosheve Bora Zemanit dhe Klaudia Pepës kanë prezantuar në garën e 20-të të spektaklit gjigant, njëft artistë shqiptarë me projekte muzikore tepër të bukura. Është e vështirë të përcaktosh se cila nga këngët është e preferuara e publikut megjithëse ata e kanë dhënë vlerësimin e tyre, duke klikuar në "Youtube" këngët më të pëlqyera nga ata deri tani. Edhe pse disa favorizohen nga fakti që janë publikuar më herët se të tjerat, deri tani duket se 5 të preferuarat, referuar klikuesmërisë në "Youtube" janë disa këngë dhe emra të njohur. Kështu, në krye të listës qëndron Flori Mumajesi me "Plas", ndjekur nga Fifi ft Mc Kresha me "Psikopatja jote", për të vijuar me Stresin që është prezantuar me këngën "Të du mom" ndjekur nga Ardit Çuni dhe Daniela Toçi me "Qaj", si dhe balada e Ronela Hajati "Vuj". Flori Mumajesi është komentuar shumë në mediat rozë si dhe nga njerëzit për këngën "Plas", e cila është pretendentja kryesore për të fituar "Kënga Magjike". Kënga ka rrëmbyer zemrat e të gjithëve së bashku me interpretimin e kantautorit të njohur. Pas prezantimit të "Plas", u ngritën dyshimet se kënga mund të jetë një dedikim i kantautorit Flori Mumajesi për një lidhje të tij dashurie që nuk pati fundin e lumtur. Në zbuluam, gjithashtu, në vargje që i dedikohet Elvanës për shkak se përkohësisht me një deklaratë që këngëtarja ka dhënë para disa muajsh, por Flori ditën e djeshme me anë të një postimi komunikoi drejtpërdrejt me fansat e tij në "Instagram", duke theksuar se kjo është kënga e të gjithëve. "Kjo këngë nuk është vetëm kënga ime. Është kënga e të gjithë atyre që kanë dashuruar dhe dashurojnë vërtetë. Dashuria i jep kuptim jetës". - shkruan këngëtarja. Këtë vit spektakli më i madh muzikor ka pjesë të jurisë së tij emra mjaft të njohur si: Manjola Nallbani, Orgesa Zaimi, Orinda Huta dhe aktori Artan Imami, që është një risi pas dy vitesh duke qenë se juria ka qenë me të njëjtët anëtarë për dy vite rresht. Por surprizat nuk mbarojnë këtu. Në njoftimin e festivalit thuhet:



"Këtë 20-vjetor festivali "Kënga Magjike" sjell dhe një risi teknologjike. Për herë të parë në Shqipëri

Livestream në VR. Mund të përjetoni emocionet e skenës, edhe nga shtëpia, nëpërmjet realitetit virtual. Sa për



garën, si çdo vit tjetër fituesin e përcaktojnë vetë artistët me votat e tyre, të cilat bëhen krejtësisht të ditura në natën

finale të festivalit. Nata e fundit e "Kënga Magjike", ku dhe do të triumfojë një prej produksioneve do të mbahet

më datë 8 dhjetor në Pallatin e Kongreseve. Deri atëherë urojmë që të fitojë kënga më e bukur!



Xhensila do ju gëzojë zemrat me këtë fjalë për të bijën

Xhensila Myrtezaj dhe Bes Kallaku janë një prej çifteve më të dashur të showbiz-it shqiptar. Ata janë mjaft aktivë në rrjete sociale dhe gjithmonë rrëmbejnë vëmendje me postimet e tyre të herë pas hershme. Në muajin korrik ata u bënë prindër për herë të parë me një vajzë të cilën e pagëzuan me emrin Ajka. Mirëpo deri më sot asnjëri prej të dyve nuk ka postuar asnjë foto të vogëlushes. Së fundmi, teksa ndiqte njëri prej performancave në "Këngën Magjike", Xhensila po filmonte ekranin e televizorit dhe po këndonte, mirëpo këngën e saj e ka ndërprerë zëri i ëmbël i Ajkës, e cila më pas fillon të qajë, ndërkohë që Xhensila qesh. "O jetë", dëgjohet t'i thotë këngëtarja Ajkës dhe më pas ka nisur të këndojë sërish këngën që po ndiqte në ekran.



Reperi italian ironizon Noizyn, zbuloni për çfarë bëhet fjalë

Noizy është padyshim një ndër reperët më të suksesshëm shqiptar, i cili me këngët e tij u bë tejet i dashur për të rinjtë. Ai realizon shumë koncerte në të gjitha trevat ku ka shqiptarë dhe sigurisht që pjesëmarrja është e shumtë e jo më kot grupi i tij OTR pëlqehet shumë nga publiku. E teksa kohët e fundit reperi ka qenë në qendër të vëmendjes për shkak të një konflikti me këngëtarin Seven Saraqi, tanimë duekt se një "debat" tjetër do të plasë në show-bizz. Ka qenë reperi italian, Fedez i cili, me anë të një videoje në Instagram e ka ironizuar reperin. Teksa ka qenë së bashku me bashkëshorten e tij Chiara Ferragni dhe djalin e tyre Leo në shtëpi në një moment Fedez i flet për lajmin e ndarjes së Cardi B nga Offset, ndërsa më pas i drejtohet vogëlushit:

"Shkruaj një artikull për Noizy-n. Ke moshën e duhur për të shkruar një artikull për Noizy-n". E dëgjuam mirë? Tha vërtetë Noizy apo na bënë në veshët? Mesa duket po dhe kjo është një formë tallëse për reperin shqiptar, duke treguar në këtë mënyrë që fansat e tij janë minorenë.



Roza Lati merr vendimin e shumëpritur, mësoni të fshehtë e moderatores

Roza Lati është një nga moderatores më të komentuar në rrjet, e cila di gjithmonë si të tërheqë vëmendjen e mediave dhe të publikut. Ajo së fundmi ka shprehur publikisht dëshirën për t'u bërë nënë me anë të një postimi në rrjetet sociale. "Si dukem këtu, sikur jam shtatzënë, dhe meqë kam rënë në dashuri për të 700-tën herë me të njëjtin person, po mendoj seriozisht të bëj një bebe. Se më shkola mesa po shikoj te kjo foto. Si mendoni ju tani me një çun apo me një gocë," shkruan 30-vjeçarja krahas fotos ku shihet që ka veshur një pelush leopardi që e tregon me bark të fryrë. Shumica prej komentuesve i kanë uruar që të bëjë vajzë, dhe me një karakter si ai i vetë moderatores.



Tayna shokon me deklaratën e saj, ja kujt do t'i jepte puthje franceze

Ajo është një prej reperiëve më të njohura e të komentuar të momentit në Shqipëri. Bëhet fjalë për Tayna-n, këngët e të cilës tashmë janë kthyer në hite. Ajo ka treguar edhe një herë se sa shumë e do veten. Me anë të një postimi në 'Istastory', reperi ka ndarë disa vargje të autorit shqiptar Azem Shkreli. Varg-



jet e njohura të poemës 'Njerëzit' thonë: "Sikur të takoheshim me vetveten sy me sy/ do të putheshim apo kishim për t'u pëshyty?" Ndërsa kësaj pyetje Tayna i është përgjigjur duke thënë se do t'i dhuronte vetes puthje, madje atë franceze.

Funerali i babait, Bush i lë diçka në dorë Michele Obamës

Lamtumira ndaj ish-presidentit, Trump përshëndetet me Obamën, shmang Bill Clinton

Gjatë funeralit të Georxh H.W Bush të zhvilluar në Katedralen Ndërkombëtare të Washington ditën e djeshme nuk kanë kaluar pa vëzhguar edhe veprimet e djalit të të ndjerit. Në një video të përhapur gjerësisht në rrjete sociale duket ish-presidenti amerikan, George W Bush që përballtet me Michele Obamën. Ish-presidenti, në fakt përpara se të ulet, afrohet në rreshtin ku ndodhen të ulur Presidenti Trump, Zonja e Parë Melania, Obama me Michele dhe Clinton me gruan e tij Hillary. Gjatë përshëndetjes me Michele Obamën, Bush i lë diçka në dorë ish-Zonjës së Parë, mbase një

DETAJI GJATE FUNERALIT TE BUSH

Në një video të përhapur gjerësisht në rrjete sociale duket ish-presidenti amerikan, George W Bush që përballtet me Michele Obamën. Ish-presidenti, në fakt përpara se të ulet, afrohet në rreshtin ku ndodhen të ulur Presidenti Trump, Zonja e Parë Melania, Obama me Michele dhe Clinton me gruan e tij Hillary. Gjatë përshëndetjes me Michele Obamën, Bush i lë diçka në dorë ish-Zonjës së Parë, mbase një

gruan e tij Hillary. Gjatë përshëndetjes me Michele Obamën, Bush i lë diçka në dorë ish-Zonjës së Parë, mbase një karamelle. Dhënia e karamelve konsiderohet një gjest mjaft i ëmbël dhe me një rëndësi

të veçantë. Një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe gjatë funeralit të John Mçain. Ndërkaq, një tjetër detaj u vu re gjatë funeralit të George H. W. Bush në Washington. Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump

dhe paraardhësi i tij Barack Obama u përballën për herë të parë që nga janari 2017. Trump dhe Melania shtrënguan duart me çiftin Obama dhe zonja e parë shtrëngoi dorën me Bill Clinton dhe përshën-



deti me dorë Hillary Clinton, por presidenti Trump dhe çifti Clinton nuk patën asnjë takim. Madje në videon e publikuar nga "The Guardian" shihet se si Trump përshëndet filli-

misht Obaman dhe me pas Michele, por shmang dhënien e dorës me Bill Clinton, i cili nuk e fsheh dot shikimin. Nga ana tjetër, Hillary Clinton nuk ua hedh sytë fare.

Theresa May, kryeministria britanike është akuzuar dje se po përploqet t'u servirë informacione të pasakta parlamentareve mbi marrëveshjen e Brexit, duke refuzuar fillimisht publikimin e një qëndrimi ligjor, pasi mund të çonte në kundërshtimin ndaj tekstit. Gjatë seancës së pyetjeve drejtuar qeverisë, Ian Blackford, deputet i partisë nacionaliste skoceze tha se kryeministria po kërkon të fshehtë faktet dhe të mashtronte Dhomën e Komunëve, duke kundërshtuar publikimin e qëndrimit të përpiluar nga Prokurori i Përgjithshëm, Geoffrey Cox (ministri përgjegjës për këshillimin ligjor të qeverisë) në lidhje me përmbytjen e marrëveshjes. Ditën e mërkurë deputetët dhanë verdiktin e tyre me 311 vota pro dhe 293 vota kundër, pasi sipas tyre, qeveria kishte shpërfillur rolin e parlamentit, duke botuar një përmbledhje të qëndrimit në vend të versionit të plotë që ata kërkonin. Qeveria më në fund publikoi dje versionin e plotë. Geoffrey Cox thekson në këtë dokument se për artitjen e një marrëveshjeje të re që përcakton marrëdhënien e ardhshme midis Britanisë së Madhe dhe BE-së, Londra mund t'u nënshtrohet raundeve shumë të gjatë dhe të vazhdueshme të bisedimeve. Ai paralajmëroi mbi faktin se dispoztat specifike për Irlandën e Veriut, të cilat parashikojnë një standardizim rregullator të krahinës me BE-në për të shmangur një kufi fizik me Republikën e Irlandës, mund të zgjasin pafundësisht në pritje të përfundimeve të marrëveshjes së re. Këto dispoztat, të përcaktuara si "rrjeti i sigurisë" ushqejnë pakënaqësinë e deputetëve euroskeptikë, të cilët kërkojnë një shkëputje të plotë me BE-në dhe partisë DUP të Irlandës së Veriut aleatme me ekzekutivin, e cila refuzon çdo trajtim specifik për Irlandën e Veriut, duke e konsideruar si një cenim ndaj integritetit të

Disfatë e rëndë për kryeministren në parlamentin britanik

Dalja nga BE, May akuzohet për mashtrim nga deputetët

Brexit, Londra duhet t'u nënshtrohet disa raundeve bisedimesh



Kryeministria e Britanisë Theresa May

DEPUTETET KUNDER MAY

Gjatë seancës së pyetjeve drejtuar qeverisë, Ian Blackford, deputet i partisë nacionaliste skoceze tha se kryeministria po kërkon të fshehtë faktet dhe të mashtronte Dhomën e Komunëve, duke kundërshtuar publikimin e qëndrimit të përpiluar nga Prokurori i Përgjithshëm, Geoffrey Cox (ministri përgjegjës për këshillimin ligjor të qeverisë) në lidhje me përmbytjen e marrëveshjes.

Britanisë së Madhe. Por, pak para debatit për marrëveshjen për Brexit, Dhoma e Poshtme e Parlamentit britanik e ka rritur presionin ndaj kryeministres May. Deputetët i dëshmojnë qeverisë se i ka shkelur të drejtat e parlamentit. Shkaku për këtë konstatim është se qeveria pati refuzuar që t'i vërë në dispozicion Dhomës së Poshtme versionin e plotë të një ekspertize ligjore të brendshme për marrëveshjen e Brexit me BE. Prokurori i Përgjith-

hëm, Geoffrey Fox e pati argumentuar refuzimin me formulimin se paraqitja e plotë "do të binte ndesh me interesin publik" dhe do të zbulonte sekrete shtetërore. Pas kësaj, deputetë të zemëruar nisën një debat për mosrespektimin e parlamentit. Projektvendimin për këtë e paraqiti partia opozitare laburiste. Miratimi është i pasigurt. Debati i caktuar për pesë ditë për marrëveshjen e daljes nga BE duhet të kishte filluar që të

martën. Por, përballë rezistencës tej kufijve partiakë është gjithsesi e diskutueshme nëse May do të mbështetet nga një shumicë. Me dëshitimin e tanishëm në votim bëhet e qartë se ajo nuk mund të mbështetet në një shumicë të deputetëve. Se cilat do të jenë pasojat që do të ketë vendimi i parlamentit, kjo është e paqartë. Teorikisht, disa anëtarë të qeverisë mund të dëbohen për një periudhë kohe nga parlamenti.

Shtyhet taksa për karburantet, "jelekëverdhtë" nuk ndalen

Taksa shtesë për karburantet në Francë nuk do të rritet gjatë 2019-ës. Qeveria shtyu me 1 vit planin e saj nga 6 muaj që premtoi fillimisht. Por, kjo nuk i kënaqi "jelekëverdhtë", të cilët nuk do t'i ndalin protestat. Ata po planifikojnë të shtunën një tubim edhe më të madh se ai i javës së kaluar, që qëndrës së Parisit i dha pamjen e një arene lufte. I vënë me shpatulla pas muri edhe nga presioni i opozitës me kërkesën për mocion mosbesimi javën e ardhshme, kryeministri Eduard Filip u bëri thirrje palëve politike të dialogojnë për të mos e zhytur edhe më tej vendin në kaos. "Dua të ritheksion angazhimin tonë për të garantuar sigurinë dhe apeloj për qetësi. U bëj thirrje të gjitha palëve, brenda dhe jashtë kësaj sale të ulen në tryezën e dialogut për të gjetur zgjidhjen". "Jelekëverdhtë" janë të pakënaqur me këtë lëshim të qeverisë, pasi kërkojnë reduktim të mëtejshëm të taksës, që vetëm gjatë këtij viti e ka rritur me 23% çmimin e naftës. Protestuesit akuzojnë presidentin Macron se me reformat e tij financiare ua ka bërë kostot e jetesës të papërballeshme. Autoritetet po shqyrtojnë mundësinë e aktivizimit të ushtrisë.



Drejtori i Klubit të Prodhuesve: Po studiojmë bizneset si Shqipëria

Prodhimet nga Serbia, Kosova studion rajonin për zëvendësimin Aleksandër Vuçiç dorëzohet para taksës

Pas vendimit të pak thyeshem lidhur me taksën 100% ndaj Serbisë, bizneset prodhuese dhe tregtare në Kosovë thonë të kenë filluar që të gjejnë alternativa për zëvendësimin e produkteve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Vendet si Maqedonia, Shqipëria, Greqia, Kroacia, Turqia dhe Italia janë disa nga shtetet, të cilat sipas bizneseve, po shikohen si opsione për të zëvendësuar produktet finale si dhe lëndën e parë për prodhim, që më herët janë importuar nga Serbia. Qeveria e Kosovës më 21 nëntor vendosi që të rrisë në 100 për qind taksën doganore për mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Ky vendim ka nxitur reagime të ashpra të serbëve në Kosovë dhe të autoriteteve në Beograd dhe Sarajevë. Mechanizmat ndërkombëtare si Komisioni Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkuar që të hiqet taksa, duke e konsideruar taksën 100 për qind edhe si shkelje e Marrëveshjes për Tregti të Lirë CEFTA. Por, Qeveria e Kosovës, të paktën deri më tani, nuk është zbrapsur nga vendimi për tarifën 100 për qind, i cili vazhdon të mbetet në fuqi. Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, thotë për Radion Evropë e Lirë se shumë nga bizneset prodhuese tani më janë duke punuar në gjetjen e furnitorëve në vendet tjera për të zëvendësuar lëndën e parë, të cilën e kishin importuar nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegov-



Pamje nga dogana Kosovë-Serbi

ASTRIT PANXHA

"Ka një pjesë të lëndës së parë që duhet të gjendet ndonjë alternativë për shkak se nuk prodhohet në Kosovë dhe shtetet të cilat janë duke u studiuar nga bizneset janë: Maqedonia, Bullgaria, Kroacia, Italia dhe Shqipëria", thekson Panxha.

ina. "Produktet e Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës për të cilat ka taksë 100 për qind mund të zëvendësohen me produkte vendore. Ka prodhim të mjaftueshëm të kategorive të ndryshme të produkteve

që mund të zëvendësohen, për shembull qumështi, vaji, biskotat mund të zëvendësohen me produkte vendore. Ka një pjesë të lëndës së parë që duhet të gjendet ndonjë alternativë për shkak se nuk prodho-

het në Kosovë dhe shtetet, të cilat janë duke u studiuar nga bizneset janë: Maqedonia, Bullgaria, Kroacia, Italia dhe Shqipëria", thekson Panxha. Nga ana tjetër presidenti serb, Aleksandër Vuçiç shfaqet i dorëzuar përballë betejës me Kosovën për tatin me 100% të vlerës për mallrat nga Serbia. Në një intervistë televizive, Vuçiç shpjegon arsyet pse Serbia po has në vështirësi përballë Kosovës. "Jemi në një situatë, ku nuk mund të luajmë shah me dikë që ka ndihmën e 10 spektatorëve, siç janë Gjermania, Britania e Madhe e Franca. Kur ke një kundër-

ALEKSANDËR VUÇIÇ
"Jemi në një situatë ku nuk mund të luajmë shah me dikë që ka ndihmën e 10 spektatorëve, siç janë Gjermania, Britania e Madhe e Franca. Kur ke një kundërshtar të paparashikueshëm, përfundimisht ky është një problem", ka thënë Vuçiç.

shtar të paparashikueshëm, përfundimisht ky është një problem". Vuçiç shpreh bindjen se paqja në rajon do të ruhet dhe nuk do të ketë luftë me Kosovën. "Nuk më pëlqen as ta përdor fjalën luftë. Shpresoj të ruajmë paqen. Jam i bindur më së miri se nga ana jonë do të arrijmë ta shmangim luftën. Duhet të vendosim komunikimin me NATO-n, në mënyrë që të marrë përsipër detyrimet që të mos ketë prani të ushtrisë së Kosovës në veri". Autoritetet serbe përlogarisin 42 milionë euro dem ekonomik muoj nga taksa doganore kosovare.

SHKURT

Arrestohet kërcënuesi i presidentit serb

Policia serbe ka arrestuar një person, i cili ka kërcënuar me vdekje presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç. Djuro Trkulja nga Novi Sad është arrestuar mbremë nga policia serbe, pasi në "Twitter" kishte kërcënuar me vdekje presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç dhe paralajmëroi rrëmbimin e anëtarëve të familjes së tij. Mediat serbe raportojnë se Trkulja është arrestuar nga policia, pas publikimeve në profilin e tij. Jozyrtarisht, por mediat serbe kanë mësuar se bëhet fjalë për profilin "@AgentStrani", përdoruesi i së cilit ka shkruar se: "Fundi i Vuçiçit është afër dhe askush nuk mund ta ndalë".

Ambasadori kinez në Serbi: S'do të ketë luftë në Kosovë

Ambasadori kinez në Beograd, Li Manchang, tha gjatë një bisede me studentët e Universitetit të Beogradit se në Kosovë nuk do të ketë luftë. Li në tribunën "Vendi dhe roli i Kinës në rendin global e sidomos në Ballkan e Serbi", duke iu përgjigjur në pyetjeve të studentëve se a do t'i ofrojë Kina ndihmë Serbisë po ndodhi konflikti në Kosovë, është përgjigjur me pyetjen: "Pse të luftojmë, kur mund të flasim"? "Nuk do të ketë luftë, pse të kundërvihemi kur mund të ulemi e të bisedojmë. Politika e jashtme kineze përqipet për gjidhje paqësore", ka thënë Li. Ai përsëriti se Kina respekton Serbinë, integritetin territorial si dhe pavarësinë e saj. "Tajvani është pjesë përbërëse e Kinës. Ajo është provincë e jona dhe ne e falënderojmë shumë qeverinë e Serbisë dhe popullin serb, që e përkrahin Kinën në këtë pikëpamje. "Nga ana tjetër, ne nuk e njohim Kosovën dhe mendojmë se çështja e saj duhet të zgjidhet në kuadër të Rezolutës 1244 dhe me dialog", ka thënë ai.

Papa Françesku do vizitojë Emiratet e Bashkuara

Papa Françesku ka pranuar ftesën e princit të kurores së Adu Dabit dhe zyrtarisht do të vizitojë Emiratet e Bashkuara Arabe. Kjo është vizita e shtatë e Papës në një komb mysliman, që nga marrja e drejtimin të kishës, ndërsa atje do të marrë pjesë në një takim ndërfaqet. Ky lajm ka ngjallur interes të jashtëzakonshëm jo vetëm në vendin ku do të shkojë Papa, por edhe mediat botërore, të cilat kanë raportuar mbi këtë lajm të kreut të Selisë së Shenjtë. Vizita e Papës do të zhvillohet në 3 dhe 5 shkurt të vitit 2019. "Ati i Shenjtë i përgjigjet edhe një ftese të princit të kurores të Abu Dabit, Mohammed ben Zayed Al-Nahyane dhe Kishës Katolike të Emiratëve të Bashkuara Arabe", njoftoi Vatikani.

Ramush Haradinaj: Ushtria e Kosovës formohet në 14 dhjetor

Kryeministri kosovar i prerë për FSK, zbulon telefonatën me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

për një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Gjithashtu, shpreha respektin dhe ndjenjën e thellë për shumë ushtarë të NATO-s, që kanë

humbur jetën gjatë shërbimit të tyre në Kosovë. Duke shprehur mirëkuptim për qëndrimin e tij nga perspektiva multilaterale për procesin e tranzicionit, njëko-

RAMUSH HARADINAJ
"E informova Sekretarin e Përgjithshëm Stoltenberg se Kosova është e përkushtuar për një proces të tranzicionit të FSK-së, që do të sigurojë një ushtri profesionale, multietnike dhe kredibile në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ky vendim sovran i Kosovës, i cili do të votohet më 14 dhjetor përmban në vete vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës, që të ruajnë dhe mbrojnë vlerat perëndimore", ka shkruar Haradinaj.

hësisht e informova sekretarin e përgjithshëm Stoltenberg se Kosova është e përkushtuar për një proces të tranzicionit të FSK-së, që do të sigurojë një ushtri profesionale, multietnike dhe kredibile në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ky vendim sovran i Kosovës, i cili do të votohet më 14 dhjetor, përmban në vete vizionin dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës që të ruajnë dhe mbrojnë vlerat perëndimore. FSK do të kontribuojë për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Institucionet e Kosovës do të sigurohen të vazhdojnë bashkëpunimin e ngushtë me KFOR dhe NALT, pasi që ndajmë të njëjtat shqetësime të sigurisë, interesat dhe vlerat", shkruan kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

FILMI



"KAVALIERI I KRUIJËS"

Shfaqet në Romë filmi i xhiruar në Shqipëri më 1940

Fatmira Nikollë

Në Casa del Cinema, në një 'rassegnà' mbi kinemanë koloniale fashiste shfaqet filmi italian 'Il cavaliere di Kruja', xhiruar në Shqipëri më 1940. Roland Sejko thotë për "Gazeta Shqiptare" se e zgjodhi "si një ndër filmat që s'është parë thujasë asnjëherë dhe do shfaqim një kopje që është në Cineteca Nazionale, ndoshta e vetmja. E veçanta e filmit është që është i pari film artistik që është xhiruar ndonjëherë në Shqipëri dhe që shfaqet për herë të parë pas shumë vitesh".

Dje në mbremje në Shtëpinë e Kinemasë u shfaq "Kalorësi i Krujës" nga Carlo Campogalliani, 1940. Është filmi i parë i filmuar në Shqipëri. "I vetmi film propagandistik që fashizmi i kushtoi Shqipërisë dhe rrallë kishte një projektion në periudhën e pasluftës. Nuk shkëlqen për cilësitë e tij artistike, por ende ndihmon në thellimin e mekanizmave të kinemasë propagandistike. Filmi është parqitur në rishikimin "Pushtimi i Perandorisë dhe ligjet racore". Casa del Cinema, Romë, ora 21.00", thotë Sejko.

Në film interpretojnë aktorët Luigi Carini, Guido Celano, Antonio Centa, Vasco Creti, Dino Di Luca, Doris Duranti, Carlo Duse, Leda Gloria, Ealter Lazzaro, Arnaldo Arnaldi, Oscar Andriani, Katijsca Odinzova, Noelle Norman, Giuseppe Rinaldi, Scerif, Nico Pepe, Emilio Petaci.

SINOPS

Në Shqipëri, një gazetar italian i ri njuh një vajzë shqiptare. Ndjejnë afeksin të përbashkët.

Një ditë gazetari shpëton një udhëheqës fisi, nga regjimi i Mbretit Zog dhe pasi e transporton në fshatin e tij të plagosur



nga të shtënat e miqve të mbretit; bie dakord të bëjë një

"pakt gjaku" me të: Ky pakt, sipas ligjit në malet e Shqipërisë;

Roland Sejko: Është i pari film artistik i xhiruar ndonjëherë në vendin tonë

krijon një lidhje familjare vël-lazërore. Kur gazetari mëson se kryetari i fisit, është vëllai i vajzës që ai dashuron; ndjehet i detyruar - duke pasur parasysh lidhjen e gjakut - të heqë dorë nga ëndrra e tij për martesë. Gjendja emocionale e tij shfrytëzohet me zgjuarsin nga prefekti i Policisë së Tiranës, i cili kërkoi ta vërë prijesin e fisit kundër gazetarit italian. Kjo do të përfundonte tragjikisht në qoftë se ardhja e trupave italiane nuk do të lejonte që ndonjë keqkuptim të sqarohet. Kritika e kohës shkruante se

filmi është "i plotë me ngjyra të mirëfillta lokale, festa popullore ku sheh rite, valle dhe këngë-ky është sfondi i historisë. Filmi duket se i përgjigjet plotësisht qëllimeve të krijuarit të saj, pritis së publikut, që është të shikuarit për herë të parë në ekran të asaj që jetojnë (...) Duartrokitje të mëdha përshëndeti lloji të ri të Campogalliani dhe angazhimit të interpretuesve të saj, dmth, ndër më të mirat, i Duranti dhe lavdia, Centa, Celano dhe Rinaldi rinj. (A. Albani Barbieri, "Tri-bune", 1940/09/07).

Është mbajtur në datat 3, 4 dhe 5 dhjetor nga Akademia e Studimeve Albanologjike Edicioni i IX i Ditëve të Albanologjisë. Pjalën e hapjes së veprimtarive e mbajti Rektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Akademik prof. dr. Marengon Verli, i cili ka qenë një vit i rëndësishëm kushtuar Skënderbeut. Ai ka përkruar edhe me një sërë ngjarjesh të tjera të rëndësishme si, 140-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 110-vjetori i Kongresit të Manastirit, 100-vjetori i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, etj.

Në 3 dhjetor zhvilloi punimet Konferenca shkencore "Skënderbeu dhe epoka e tij", ku referuan Prof. dr. Aurel Plasari për "Tësotmen dhe të ardhmen e studimeve skënderbegiane"; Dr. Elvana Metalla, "Kruja në periudhën e mesjetës, rivlerësim mbi të dhënat arkeologjike"; Prof. dr. Skënder Muçaj - dr. Suela Xhyheri për "Kastriotët dhe fisnikët e tjerë shqiptarë në fushën e ndërtimeve mbrojtëse dhe kishtare në

shek. XIII-XV; Prof. dr. Adem Bunguri për "Kontributi i arkeologjisë në identifikimin e fortifikimeve të periudhës së Skënderbeut në rajonin e Dibrës"; Dr. Eduart Caka me "Analizë e aspektit burimor në historiografinë skënderbegiane shqiptare (me përqendrim në dokumentacionin dhe literaturën osmane)"; Prof. dr. Ksenofon Krisafi me "Politika e jashtme dhe diplomacia e Skënderbeut"; Prof. dr. Gazmend Shpuza me "Çështja e alfabetit në Kongresin e Dibrës"; Dr. Pranvera Bogdani me "Shteti i Balshajve një deçaj vu i shtetit të Skënderbeut"; Dr. Halil Shabani, "Zenabishtët dhe Delvina, aleatë të Skënderbeut nga "Arbëria e Poshtme"; Dr. Dorian Koçi me "Imazhi i figurës historike të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në Pashallëqet shqiptare (1784-1831); Dr. Ermela Broci me "Një studim bibliografik mbi Skënderbeun: 1940-1990; Dr. Olsi Lelaj me "Heroi Kombëtar: Një perspektivë antropologjike"; Prof. dr. Afërdita Onuzi me "Veshjet shqiptare në shekujt XIV-XV (reflektim et-

DITËT E ALBANOLOGJISË RIMBLEDDHIN STUDIUESIT



nografik); Dr. Mikaela Minga me "Fan Noli, Skënderbeu dhe muzika"; Prof. dr. Miaser Dibra me "Refleksione mbi komunikimin emocional shprehës në trashëgiminë gojore për Skënderbeun"; Prof. asoc. Dr. Nebi Bardhoshi me "Etnografia për Skënderbeun: kozmologji antropologjike mbi figurën e heroit"

17. Prof. dr. Valter Memisha, "Vështrime shkencore për figurën e Skënderbeut në faqet e revistës "Studime filologjike", etj. Ditën e dytë, më 4 dhjetor zhvilloi punimet Konferenca "100 vjet gërmime arkeologjike në Shqipëri. Prezenca austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare". Kjo konferencë e cila er-

dhi si bashkëpunim mes Institutit të Arkeologjisë (pranë ASA), Ambasadës Austriake në Tiranë dhe Muzeut Historik Kombëtar, kujton kontributin e misioneve austro-hungareze në arkeologjinë shqiptare si dhe synon të japë një panoramë të përgjithshme të rrugëtimit të tyre shkencor. Gjatë ditës së tretë të veprimtarive Ditët e Albanologjisë, u hap në ambientet e Institutit të

Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit ekspozita me temë: "Një etnografi për kohën e Skënderbeut".

Nëpërmjet kësaj ekspozite synohet të paraqitet kultura shqiptare në periudhën e Mesjetës. Objektet që u ekspozuan ishin: veshje, stoli, pajisje të mjedisit shtëpiak, armë të kohës së Skënderbeut, etj.


Ekspozita u organizua nga kuratore Prof. dr. Afërdita Onuzi, Dr. Ermela Broci dhe dy specialistet e fondeve Vilma Nallbani dhe Migena Dukagjini.

BOTIMI

35,000 faqe për Arbërinë e Skënderbeun në Dubrovnik

Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë në kuadër të aktiviteteve kushtuar Vitit Jubilar të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, botoi vëllimin me dokumente "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut: dokumente", hulumtuar dhe përgatitur për botim nga Prof.asoc.dr. Gjon Berisha. Botimi i këtyre dokumenteve është një përfundim me sukses i punës hulumtuese disa vjeçare në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut nga studiuesi i periudhës së mesjetës, Berisha, i cili si rezultat i punës hulumtuese në arkivin në fjalë pati rastin që të hulumtoj dhe grumbulloj rreth 35,000 faqe dokumente që ndërlidhën me Arbërinë dhe arbërorët në mesjetë, të cilat dokumente për nga përmbajtja e tyre ju takojnë fushave të ndryshme si: ekonomike, politike e kulturore. Nga këto dokumente të hulumtuara dhe grumbulluara gjatë katër viteve të fundit, një pjesë e tyre, që i kushtohen Epokës së Gjergj Kastriotit, gjejnë vend në këtë përmbledhje me dokumente.

Një përmbledhje e tillë me dokumente tematike, kushtuar Gjergj Kastriotit, dhe që na vijin vetën nga një arkiv, siç është



Botimi i ri i Gjon Berishës, tekstet dhe përkthimet bashkë

Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut (DAD), nuk ka ekzistuar më herët, prandaj është mirëseardhur për studiuesit e mesjetës në veçanti dhe lexuesit në përgjithësi. Edhe në aspektin metodologjik, vëllimi është i punuar me kujdes të veçantë, ku krahas tekstit të dokumentit original, gjendet përkthimi në gjuhën shqipe. Kurse, për kureshtarët dhe studiuesit që dëshirojnë të bëjnë krahasime me dokumentet origjinale, studiuesi Berisha, në fund të vëllimit ka rradhitur faksimilet e shumicës së dokumenteve të botuara, të shoqëruara me shënime plotësuese për vendndodhjen e tyre dhe datën e dokumentit. Thënë ndryshe, fondet arkivore kushtuar Gjergj Kastriotit që gjenden në DAD, tani i kemi në një vend, në një libër dhe në gjuhën shqipe.

Vëllimi me dokumente i cili jo rastësisht po i prezantohet lexuesit në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, përmban 228 dokumente që nga pikëpamja kronologjike përfshijnë periudhën kohore nga 21 marsi i vitit 1413 deri më 1 mars të vitit 1468, kohë kjo kur krahas kryengritjes së Gjon Kastriotit në pranverën e vitit 1430, pasuan edhe kryengritjet në viset e tjera të Arbërisë.


Gjithashtu në periudhën në fjalë Arbëria u përball me luftërat e vazhdueshme të Skënderbeut kundër ushtrive osmane.

Vlen të theksohet se Gjon Berisha duke përgatitur për botim këto dokumente ka treguar kujdes të veçantë, në radhë të parë, duke i dhënë të plota fondet e Arkivit të Dubrovnikut prej nga edhe i ka marrë dokumentet që po botohen, pastaj vëmendje e veçantë i është kushtuar dokumenteve me rastin e transkriptimit dhe përkthimit të tyre, që ka qenë një punë mjaftë e mundimshme, por falë punës këmbëngulëse të tij dhe redaktimit profesional të bërë nga redaktori Fajton Balliu, kanë bërë që këto dokumente, po e themi në kuptimin figurativ, të flasin për një ndër periudhat më të lavdishme të historisë sonë.

Për t'i bërë sa më të lehta për lexuesin, të gjitha dokumentet, studiuesi Berisha, i ka shoqëruara me një kokë, apo fjali që tregon përmbajtjen e dokumentit, shënime sqaruese në fund të faqes, në raste kur e ka konsideruar të nevojshme, si dhe fondin ku gjenden dokumentet origjinale dhe në rastet kur është i botuar, krahas origjinalit është dhënë edhe referenca e dokumentit të botuar.

AGIM KRAJKA SHPALLET "NDERI I KOMBIT" NË KONCERTIN E KARRIERËS

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor shfaq në 7 dhe 8 dhjetor, ora 19:00 në arTurbina - Grand Gala "Të gjithë e duan Agim Krajkën". Kemi një vit që celebrim me performanca të shumta 60-të vjetorin e Ansambllit Popullor të Këngëve dhe Valleve, për të përmblytur kështu festimet me këtë koncert kushtuar një artisti të madh, që ka kompozuar e drejtuar për 30-të vjet me radhë orkestrën e AP. Gjatë koncertit të datës 7 dhjetor në arTurbina, Presidenti i Republikës Ilir Meta do të dekorojë me titullin e lartë "Nderi i Kombit", "Mjeshtër i Madh" të muzikës shqiptare, Agim Krajka. Ju lutemi të mbulonit mediatikisht këtë ngjarje të rëndësishme të kalendartit artistik Shtator - Dhjetor 2018 të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, për një nga figurat më të mëdha të artit dhe muzikës shqiptare. Agim Krajka i kushtoi çdo ditë të karrierës së tij artistike, folklorit muzikor duke e eksploruar në çdo cep të Shqipërisë, për ta patur si muzën më të shtrenjtë, më të dashur, e cila do ti jepte frymëzim më të bukura per



veprat muzikore, të cilat gjithmonë bënin tendencë e muzikës së kohës. Ai ishte i fundit që shkëputej nga folklori dhe i pari që ndiqte trendet e muzikës së kohës, prandaj të gjithë e kërkonin dhe donin të bashkëkrijonin e ndanin skenën me të. Publiku e dëshironin te pa fund kur luante në fizarmonike dhe mezi priste të dëgjonte këngë e tij në festivalin e fundvitit. Miqtë dëshironin ta kishin afër në tryezë për tu gëzuar me alegrinë që shpërndante përreth. Ndaj të gjithë e donin dhe e duan Agim Krajkën.

Agim Krajka erdhi në Ansambllin Shtetëror 54 vjet më parë si fizarmonicist me aftësi të rralla dhe individualitet virtuoz. Ai më pas u bë dirigjenti dhe për-

punuesi më i rëndësishëm në historinë e AP. Ashtu si "Mjeshtër i Madh" - Panajot Kanaçi, që e ngriti trupën e valleve të AP në nivele tejet të larta duke e ngritur vallen popullore në majën më të lartë të interpretimit edhe "Mjeshtër i Madh" - Agim Krajka e ngriti në këto nivele ekzekutim e melodive të valleve popullore. Ai me klasin dhe talentin e tij ndërtoi një strukturë më formacionin e orkestrës, i cili nuk ishte parë deri në atë kohë. Ndërtoji modele orkestrimesh e përpunimesh të këngëve dhe valleve nga gjithë krahinat, duke ruajtur me fanatizëm karakteristikat ritmike e melodike. Kjo strukturë mbajti gjatë, deri më sot, gjithë peshën e krijimtarisë së Ansambllit Popullor të Këngëve dhe Valleve.

Krijimtaria e tij mori vlera të tjera me muzikën e shumë filmave, të cilat i kompozoi gjatë viteve 70-80. Kryeveprat e kinematografisë si: "Cifti i lumtur", "Zonja nga qyteti", "Një shoqe nga fshati" etj, nuk do kishin vend të veçantë në historinë e kinematografisë tonë, pa kolonat zanore që shkroi për të "Mjeshtër i madh" - Agim Krajka.

ENVER PETROVCI "KREOLËT E BALLKANIT", DRAMA QË PARASHIKOI LUFTËN

Dhjetë vite para luftës në Kosovë, Enver Petrovci do të shkruante dramën "Kreolët e Ballkanit" duke i parashikuar saktë ngjarjet e kësaj lufte ndodhur para dhe pas saj. Pjesa vjen premierë në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në Tiranë për publikun. Nën regjinë e autorit Enver Petrovci "Kreolët e Ballkanit" sjell histori dashurie, aksion dhe dramë. Ajo ngjitet në skenë më 8 dhe 9 dhjetor. Autori ka bërë pjesë të këtij teksti çdo emocion njerëzor si dashurinë, lumturinë, hakmarrjen, tradhtinë, por edhe shpresën për një botë më të mirë, për një atdhe më të dashur i cili ka nevojë të ul në prehrin e tij; dashurinë, fitoren dhe lumturinë. Për Enver Petrovcin në këtë botë disa luftojnë për tokën dhe të tjerë për shpirtin. "Bota përbëhet prej të papërcaktuarave, disa luftojnë për shpirtin dhe të tjerë për tokën" shprehet autori Enver Petrovci. Puna për ta sjellë në skenë e teatrit ka vijuar para disa kohësh dhe në role janë aktorë nga Kosova dhe Shqipëria. Rolet në dramën "Kreolët e Ballkanit" regjisori Enver Petrovci

ia ka besuar aktorëve si Agron Shala, Elidon Alika, Kristian Koroveshi, Kriks Dumosia dhe Vanesa Petrovci. Skenografia është e realizuar nga Beqo Nanaj, kostumografe Sofi Kara, as. regjisori Enkelelda Fisheka. Këtë herë vepra shënon premierën në Tiranë, por ajo nuk ka munguar dhe në skenën e Kosovës. Disa vite më parë kjo veprë teatrore është dhënë premierë në skenën e Prishtinës, ku atje është ndjekur me vlerësimin e publikut. Këtë muaj të fundit të viti kjo premierë teatrore, që i takon dramaturgjisë shqiptare është në skenën e Tiranës. Këtë herë për premierën e Tiranës janë aktorë që publiku i njeh për aktivitetin me teatrin, por mes tyre rol i ka besuar dhe vajzës së tij Vanesa Petrovci. Vepra pas skenës së Tiranës mendohet që do të vijojë më pas dhe në skenat e teatrit në Kosovë.

Është një ndër themeluesit e degës së Artit Dramatik dhe Akademisë së Arteve në Universitetin e Prishtinës në vitin 1989, ai kthehet nga Beograd për të ligjësuar lëndën e aktrimit në këtë universitet dhe formon kuadro të reja të aktorëve në Kosovë

Opinion i Ditës

Përthyerje për të qëmtuar: Teatri i Metropolit ndërmjet zgjedhjeve dhe zgjidhjeve

Nga Valbona Nathanaili

(vijon nga faqja 1)

... për ndikimin në komunitet të dy edicioneve të "MetroFest", "MetroFest 1" (2017) dhe "MetroFest 2" (2018). Është hera e parë që një institucion merr një nisim të tillë dhe duhen përshëndetur, në veçanti, drejtorja Jonida Beqo dhe përgjegjësjat për sektorin e edukimit Sonila Kapidani, sikundër t'i falënderoj për të qenë pjesë e panelit. Duke qenë se e kam ndjekur me vëmendje aktivitetin e Teatrit të Metropolit, duhet theksuar se përgjatë këtyre dy vjetëve, ku përveç shfaqjeve, një vend të rëndësishëm kanë zënë edhe Klubi i leximit, apo shkolla e kurseve organizuar me grupmosha të ndryshme, kam të gjitha arsytet të vendos në sfond të analizës teatrin si agjenci, pra si institucion që funksionon me të gjitha opsionet: ka kapital njerëzor të kualifikuar, ka strategji, ka objektiva për të vepruar në mënyrë të orientuar ndaj botës sociale, një Teatër i Metropolit që lufton Monopolin në mënyrën e të menduarit dhe guxon të përziejë shijet e grupeve të ndryshëm.

Në periudhën 1939-1941, që korrespondon me kohën kur Shqipëria ka qenë nën pushtimin italian, ministër Arsimit ka qenë Ernest Koliqi, një nga mendjet më të shquara të këtij vendi në fushën e kulturës dhe krijimtarisë, njëherazi shumë i diskutuar për arsytet që e kanë shtyrë të pranojë bashkëpunimin me pushtuesit e vendit. Por, synimi ynë është të ndalemi në atë dimension të veprimtarisë së tij që e bën me nder dhe për të cilën e respektojmë, - krijimtarinë dhe pasionin për kulturën - dhe që nuk i kanë munguar edhe kur ka qenë në postin e ministrit. Në kulmin e veprimtarisë si ministër i Arsimit, u dërgon të gjitha shkollave një qarkore, nëpërmjet së cilës u kërkon mësuesve të përfshihen në mbledhjen e folklorit në zonat ku japin mësim. Nga 22 pyetje që përmbante qarkorja, mësuesit duhet të zgjidhnin 2-3 "për t'i studiuar e shtjelluar me kujdesin më të madh, peshuem dhe matur mirë, pa shtuar ndonjë gjë nga fantazija dhe pa lënë të metë gjëkafshë për çdo arsye qoftë", - porosiste Koliqi. Disa nga pyetjet për të cilat mund të mblidhnin të dhëna janë:

" Dëfteni një për një zakonet e lindjes, pagëzimit, synetit, fejesës e vlesës, martesës e vdekjes (të tretat, të shtatat, të nëntat, të dyzetat). Tregoni çfarë urimesh e çfarë thuhet me rastin e këtyre ngjarjeve!



" Si e parashikojnë bujqit ardhjen e kohës së mirë ose të keqe, si shiun, breshrin, borën, dimrin e rreptë ose të butë, vapën e madhe etj.? Për shembull, kur këndon gjeli në një çast të caktuar, kur piqet ndonjë pemë etj.?"

" Çfarë zakonesh e çfarë besimesh mund të ketë në katund (a në qytet), që bien fort në sy? Për shembull, dita e djegies së rrogazave në Berat, dita e flakadani, dita e rusicave (kur dikush vishet me gjethe e gjelbërime dhe i derdhin ujë) etj.

Pyetjet e qarkores së Koliqit kërkojnë të evidentojnë atë pjesë të kulturës që njihet si "Kultura e përfaqësimit", kultura që përmbëhet nga besime, norma e vlera kolektive, legjenda e simbole popullore, piktura dhe ikona, ligje e kode kanunore, pra është kultura që përfaqësohet nga një bashkësi faktesh sociale, materiale ose jomateriale, që përbëjnë një detyrim moral, një marrëveshje sociale, unike për një vend dhe kohë të caktuar. Lajmi i keq është që kjo pjesë e kulturës jo vetëm nuk përfaqëson indivi-

din, por del edhe jashtë sferës së ndërveprimit individ-individ, ndërsa lajmi i mirë është që mund të studiohet dhe analizohet dhe, në terma afatgjatë, edhe të ndryshojë, por kërkon shumë mekanizma. Grupet që merren me studime të kësaj natyre janë nga fusha të ndryshme të dijeve dhe, ndonëse secili ka këndin e vet të gjykimit dhe vështrimit, të gjithë bashkohen në një pikë: teatri luan një rol të rëndësishëm dhe është një nga mekanizmat që përshpejton ndryshimin. Thënë ndryshe, teatri është mjedisi në të cilin kultura e përfaqësimit, në rrjedhojë të misionit e funksionit të tij, përthihet, nësoj me atë që ndodh me dritën gjatë kalimit nga një mjedisi në një mjedis tjetër me koeficient të ndryshëm përthyerje. Pra, Teatri përthihet, sepse mjedisi i tij ka koeficient tjetër nga ai i realitetit. Teatri përthihet kur vepron si agjenci, rol të cilin, nga arsyetimet e mësipërme, Teatri i Metropolit e luan plotësisht.

Por çfarë ndodh dhe si mund ta shpjegojmë?

Dukuria e përthyerjes së Te-

atrit është e lidhur me dy faktorë: mënyrën si funksionojmë ne, si genie sociale, dhe teatrin si agjenci.

Ne si qenie sociale, në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat kemi jetuar të ndarë në grupe sociale, ku gjithmonë grupe të caktuara janë lënë mënjatë, janë stigmatizuar dhe kanë qenë në pozita inferiore me të tjerët, për shembull gratë ndaj burrave, vajzat ndaj djemve, romët ndaj gaxhivë, të varfrit ndaj të pasurve, të zinjët ndaj të bardhëve etj. Pra, sfondi social ose parajgjykimet që kemi, me ose pa dashje, ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përthatisës në grup, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër. Gjykimi ynë për një grup të caktuar influencohet shumë nga faktorët e mësipërm. Ajo që perceptojmë varet nga pozicioni ku jemi dhe nga ajo që shpresojmë ose jemi të bindur se do të shohim. Thënë këto, në përbëjmë realitetin dhe materializohemi në pjesën teatore.

Pra, pjesa teatrale, pavarësisht faktit se është vënë në

skenë në gjallje të autorit a pas vdekjes së tij, ose pavarësisht kohës që autori vendos në sfond të zhvillimit të ngjarjeve, na informon për kohën në të cilën është krijuar vepra, për kulturën e asaj kohe. Mënyra e ndërtimit dhe e rrjedhës së ngjarjeve, gjuha e përdorur, veshja, simbolikat, arkitektura e skenës janë të gjitha bashkë, një lloj prerje e këtij realiteti social e kulturor!

Ndërkohë, misioni i teatrit është të tregojë, ndërsa thelbi i agjencisë së tij është paraqitja e një konflikti, konkretisht konflikti ndërmjet individëve dhe rrethanave ku gjenden.

Sepse Teatri kërkon gjithnjë më shumë se çfarë ofron mjedisi, sepse teatri mban qëndrim, reflektton, hap perspektiva të reja, bind. Teatri gjeneron kënaqësi, i bën spektatorët të përtejtojnë akte subversioni ose kritika kulturore pa frikë dhe pa masa vetëmbrojtëse, edhe kur dialogët që zhvillohen janë të mbushur me paragjykimet të së shkuarës, thotë Martha Nussbaum.

Teatri na ndihmon të dëgjojmë me vëmendje dhe inteligjencë historinë e tjetrit, të kuptojmë emocionet e dëshirat që ka ose që ëndërron, ta shohim me simpati, të bëhemi tjetri vetë. Teatri, nëpërmjet agjencisë së tij vë në lëvizje të menduarin ndryshe, nga këndvështrimet të tjera, na ndihmon të kuptojmë sa e vështirë dhe diskriminuese është jeta e personave që u përkasin këtyre grupeve. Dhe të reflektojmë!

Në këtë kuadër, teatri luan rol që kultura e përfaqësimit, sado komplekse, statike dhe e rëndë që të duket, t'u nënshtrohet filtrave e gjykimeve të reja, besim të rimerren në analizë, ndërsa stereotipat të vihen në pikëpyetje.

Teatri shndërrohet në laboratorin e analizës së kulturës së përfaqësimit: çfarë na duhet dhe çfarë jo! Teatri shndërrohet në hapësirë për eksplorimin e çështjeve të vështira pa u zhytur në ankt!

Kujtoni komedinë "Diktatori" (2012) dhe batutën e Sacha Baron Cohen (njëri nga skenaristët dhe aktori kryesor), kur e dashura i thotë jam shtatzënë, ai përgjigjet: Çfarë do të lindësh, djale apo do të abortosh?

"MetroFest 1" (2017) dhe 2 (2018) organizuar nga Teatri i Metropolit kanë pasur pikërisht një synim të tillë: "Drama shqipe si laborator njohjeje dhe kërkimi". Për më tepër, një nga dramat e zgjedhura është pikërisht nga Koliqi, me titull "Rrajët lëvizin". Dramat e tjera të "MetroFest 2" janë "Kryet e Hudhrës" nga Krist Berisha, "E mbesa e krahinarit" nga Kristo Floqi (edhe z. Floqi ka qenë min- ➔



Trajneri i Kukësit sqaron se nuk ka asnjë çështje "Rexhinaldo"

Cungu: Skënderbeut i kthejmë reston e Korçës

Trajneri i Kukësit, Ar mando Cungu ka dalë dje para mediave në vigjilje të takimit të javës së 16 të superiore mes Kukësit dhe Skënderbeut. Tekniku shkodran është shprehur se skuadra e tij do të synojnë të marrë vetëm fitore në këtë takim dhe se në skuadër nuk ka një çështje "Rexhinaldo". Sakaq, ai ka folur edhe për gjendjen e futbollistëve dhe problemet

ekonomike në Superiore. "Ndeshemi me një rival direkt për titullin kampion. Pavarësisht ndeshjes së parë që nuk shkoi në rezultat siç duhet, por jo në lojë, shpresoj që nesër (sot) t'i kthejmë reston Korçës, pasi është objektivi në çdo ndeshje. Çështje Rexhinaldo? Nuk ka asgjë për ta bërë situatë. Ka pasur një shqetësim muskolor dhe për këtë arsye ka qëndruar

më vete. Nuk më pëlqeu që ka qenë në gazetë dhe i kemi dhënë leje për të qenë te fëmija kur lindi. Ai vetë ka dashur të vijë në Shqipëri dhe nesër do të shohim nëse do të jetë ose jo në gjendje të mirë fizike. Shameti është rikthyer dhe nesër është në fushë. Rrumbullaku është rikuperuar dhe është i rëndësishëm e do të jetë në fokusin tim maksimal, por nuk ka luajtur

rreth 3 muaj. Tifozët në Kamëz? Me shumë respekt për Skënderbeun dhe çfarë ka bërë, unë nuk i druham asnjë kundërshtarit dhe as djemtë. Dihet që nuk luajmë në fushën tonë dhe arsyeja që jemi në Kamëz janë tifozët, pasi kemi pasur mbështetje. I falënderojmë, pasi janë shtysë për sportistët. Nuk na favorizon shumë terreni dhe Kukësi është një ekip që luan futboll. Nuk jemi ekip që duam veç rezultat dhe të largojmë topin. Duam të jemi dëfryes në fushën e lojë dhe mendoj se po e bëjmë mirë", u shpreh Cungu.

Trajneri i bardhekuqve ka jo pak dhembje koke, me Radas e Krasniqin që nuk do të jenë të gatshëm

Orges Shehi kërkon të fitojë me Kukësin dhe të përfitojë nga ndonjë hap i mundshëm fals i Partizanit në Durrës. Tekniku durrsak i Skënderbeut e di mjaft mirë se ndaj skuadrës së Cungut do të jetë një përballje e vështirë, por beson se të tijtë do ta kalojnë me sukses këtë sfidë dhe do të rikthehen te fitorja. Sulmuesi Krasniqi dhe Marko Radas nuk do të jenë për lojë, ndërsa tashmë që korçarët janë 4 pikë poshtë Partizanit, që është edhe rivali i tyre kryesor për titullin kampion, trajneri Orges Shehi ka pohuar: "Është përballje mes rivalëve, madje ka shumë vite që Kukësi është një nga rivalët tanë kryesorë. Kërkon vlerësim maksimal për pozitën dhe situatën ku jemi. Vijmë pas një ndeshjeje me një rezultat jo të mirë, por me një lojë të mirë. Kjo na bën optimistë që të japim më të mirën dhe të dalim me maksimumin nga fusha e lojës", - tha trajneri Shehi për "Supersport". Pavarësisht mungesave të titullarëve të deklaruara

Shehi hedh dorashkën e sfidës: Skënderbeu im është për titull

Korçarët do të ndeshen me Kukësin në Kamzës



tashmë, trajneri Shehi ka besim te pjesa e skuadrës që është gati. "Radas ka

plotësuar numrin e kartonëve, por edhe Krasniqi nuk është stërvitur me

skuadrën. Por, edhe lojtarët që do të luajnë, do të bëjnë më të mirën. Per-

sonalisht unë dhe stafi jemi të kënaqur për punën që bëjmë, lojtarët që nga 5 korriku e deri më sot kanë shfaqur rritje, po luajmë futboll, shkojmë te zona e kundërshtarit dhe realisht jam i kënaqur për gjendjen e lojtarëve". Për Shehin, 4 pikë larg Partizanit nuk janë pak. "Kampionati është i gjatë, janë edhe shumë ndeshje. Mendoj se do të jetë garë shumë e fortë, pasi janë edhe ekiye që janë poshtë nesh që po ngrihen, ndaj edhe gara nuk është përcaktuar ende, ndaj parashikoj një kampionat shumë të fortë", - tha trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, në prag të sfidës me Kukësin.

SUPERLIGA		
JAVA E 16-TE		
TE PREMTEN		
Kukësi-Skënderbeu	14:00	
TE SHUTËNEN		
Tirana - Kastrioti	14:00	
Teuta - Partizani	17:00	
TE DIELEN		
Kamza - Luftëtari	14:00	
Flamurtari - Laçi	17:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	15	34
Skënderbeu	15	30
Teuta	15	28
Kukësi	15	27
Laçi	15	26
Flamurtari	15	22
Luftëtari	15	13
Tirana	15	11
Kastrioti	15	10
Kamza	15	9

TRAJNERI I SHQIPËRISË

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Kristian Panuçi, ka folur për mikrofonat e TV "Klan", ku ka prekur kualifikimin në "Euro 2020", takimin me Dukën, mundësitë që ka Shqipëria kundër Turqisë dhe Islandës, si dhe për lojtarët nga Superiorta.

Pas kaq ditësh nga shorti i Europianit dhe me një gjykim më të ftohtë, a ka ndonjë gjë që e keni rimenduar?

Jam i kënaqur me shortin. Kemi një grup ku kemi mundësi me Turqinë dhe Islandën. Sigurisht që jam ende i të njëjtit mendim që

kam nevojë për të gjithë futbollistët për të provuar t'ia dalim. Turqinë në miqësore e mundën, është një grup i vështirë për vendim e dytë, por Shqipëria mund të tentojë.

Pse mendon se do të kemi mundësi me Turqinë dhe Islandën?

Luçesku po vazhdon me rinovimin e skuadrës. Është e një skuadër e ndërlikuar, por fusha na tregoi se kemi mundësi. Mund të shkojë në Europian: Turqia, Islanda apo Shqipëria. Do të shohim dhe do të kërkojmë të jemi më të zotë se ata.

Sa i përket asaj që është thënë në media mbi ashpërs-

inë tuaj mbi polemikat, a mendoni të ndryshoni diçka në planin personal?

Kam gjetur gjithnjë shumë negativitet, mbi këtë replikoj. Ndoshta jap përshtypjen e polemikut, por duhen analizuar dinamikat e ngjarjeve. Por për mua e rëndësishme të kem gjithë skuadrën. Nuk shoqërohem me gazetarët, por kjo nuk do të thotë se nuk kam respekt për ju.

Lojtarët kanë sjellë në vëmendje ndryshimet e shpeshta të formacionit dhe rreshtimit. Do të vazhdojë e njëjta histori?

Kur ke mungesa lojtarësh është e vështirë të bësh

Panuçi: Nuk jam polemizues, grupi i lojtarëve është me mua

skuadër. Unë e kam në mendje skuadrën dhe kam folur edhe me presidentin. Duhet të kujtoni se kam provuar 20-21 lojtarë të rinj, por janë lojtarët ata që vendosin se cili do të grumbullohet me atë që tregojnë në fushë. Që prej një viti për shkak të mungesave ideja ime nuk ka funksionuar.

A keni shtylla në skuadër ku mbështeteni?

Grupi i lojtarëve është me mua. Tek unë kanë gjetur një mik. Ka pasur lojtarë që nuk luajnë në skuadrat e tyre dhe

unë i kam ndihmuar duke i grumbulluar. Por unë e di se çfarë duhet bërë për të fituar dhe këtë dua të transmetoj. Kjo bëhet gjatë stërvitjeve. Aty duhet të djersinë sepse kemi përgjegjësinë e një kombi. Po flasim për Kombëtaren, të gjithë duhet të jenë krenarë që bëjnë pjesë.

Si ia mbushët mendjen presidentit për të qëndruar?


Duka e kuptoi që ishim në vështirësi, ai e di që skuadra është me mua. Kam fatin të kem një president me nivel

intelektual më lart se mesatarja.

Këtë sezon kualifikues mendoni se duhet të jemi më shumë i pranishëm në Shqipëri, për lojtarët e Superiores?

Faji nuk është i imi, është i Bulkut që nuk më thërrret (qesh). E gjithë federata kërkon lojtarë të zotë, por duhet parë nëse zgjedhim Shqipërinë. Është grupi që mund të bëjë gjëra të rëndësishme. Nëse nuk përpiqemi të gjithë së bashku lojtarë, federate, tifozë dhe gazetarë për të shkuar në europian atëherë nuk do t'ia dalim", - u shpreh Panuçi.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Bëjnë arte me re.
- Krijoi Arsene Lupin (inic).
- Janë forma.
- Në hyrje të plazhit.
- Kapen të parat.
- Janë ufat.
- Mbahen nga ata që i thejnë.
- Inicialet e Mascagnit.
- Në krye të trupave.
- Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- Pak hemorragji.
- U shkrua nga Jack London.
- Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- Scarlet e Bashkë me erën.
- Janë tituj në ekran.
- Eric aktor.
- Kështu e ka syrin vigjilent
- Janë nofka.
- Një provë... inteligjence.
- Mund të jenë me sahat.

- Një pjesë e naivitetit.
- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohet nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prin kolonës.
- Eshtë filozofie moralit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Carnera, ish-kampion i rinqut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrënjët në tokë.
- Eshtë pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Eshtë kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushatat.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjëherë duhen vënu mbi i.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Eshtë nënë e Tironës.
- Eshtë shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari spiune.
- Oyteri i Robespierre.
- Phineas i famshëm i cirkut.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Eshtë shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Pak iniciativë.
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.
- Veriu pa kufij.


- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vajj.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

VERTIKAL


- Eshtë edhe ai i sheqerit.
- Eshtë lloj papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë.
- Eshtë pluhuri si Dash.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Eshtë për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj per-sëve.
- Provinca e boerëve.
- Eshtë qyteti i njëmbjeshit dritareve.
- Eshtë dukuria.
- Eshtë hidrokarbur.
- Griffith aktore.
- Qe perëndesha e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon çmimin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Eshtë princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerante.
- Modem pa zë.
- Pak marramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2		3			1			8
9	5	7	4				6	
4				3				
	7		1	4				2
			2					8
6			5	8			3	4
1	3			5				4
5	8	9				2		
				9	6			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	9	7	5	1	2	3	4	6
1	5	4	3	7	6	8	2	9
2	3	6	4	8	9	1	5	7
5	7	1	8	3	4	9	6	2
9	4	8	6	2	7	5	3	1
3	6	2	9	5	1	4	7	8
7	8	3	2	9	5	6	1	4
6	2	9	1	4	3	7	8	5
4	1	5	7	6	8	2	9	3

PERGJIGJET E FJALEKRYQIEVE TE NIURIT TE KALUAR

FJALEKRYQI (1)

HORIZONTAL: NGA, ADAPT, ECJA, DCASTRO, UNION, AMALIA, LARVE, LIRIA, PILADIT, ENI, KAPITALET, STIM, TALEBANE, AMHEPATITIT, ONIT, ED, EMRI, METALIK, PLANI, TRENEMMA, TIR, PIRATI, FATATA

VERTIKAL: ED, L, T, E, C, M, A, F, I, A, C, K, O, P, E, R, R, D, E, R, O, H, A, R, A, D, I, A, M, A, N, T, I, E, B, E, R, D, I, T, S, H, M, E, A, N, S, T, A, D, U, M, E, T, I, R, A, N, D, I, K, A, S, T, E, R, I, R, A, M, E, N, N, I, S, S, A, N, N, O, T, A, S, U, E, L, E, N, A, O, R, T, R, I, M, A, B, O, N, E, V, E, S, I, M, O, T, E, N, D, E, A, M, E, N, E, T, R, E, N, E, K, A, R, A, K, T, E, R, E, T, T, R, E



Argëtim filozofik

-Të flasësh pak për ato që dini dhe aspak për ato që nuk dini.

-Nuk mund të fitoni nëse nuk e dini se pse humbni.

-Nëse nuk e dini se ku shkoni, atëherë si prisni të arrini atje?

-"Fjalët e mëdha kanë një të mirë ... Mund të fshihet pas tyre një njeri i vogël".

-"Maska është e vetmja fytyrë që njeriu zgjedh vetë".

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3		19	K	A	B	D	M	T	E	T	K				
6	4	1	3		11				3	T	R	19	19	U	E	N	E	I	D	A	P	A	R	A	
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3		18	P	U	K	S	S	K	N	K	I	A	T	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3				18	A	R	S	H	T	A	T	A	N	I	K	E
13	5	11	6	4	5	10	3	5	5			14	4	T											
19			3	2	16	1	4		2	3	2			M	I	N	E	R	A	L	E	T	I	K	
7	4	6	14	5		2					1	11	5	B	O	E	R	B	I	T	B	T	U		
8	11	1		6	11	14		4	2	18	11			P	A	R	T	I	I	N	I	R			
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2			U	R	I	M	A	S	I	S	S			
18	8		4		5	7	6	14	6		3	5		L	I	M		E	N	A	O	R	I		
15	2	3	2	11		2	11	6	2	10	5	3		A	M	E	R	I	K	A	T	U	B	I	M
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6		T	E	R	R	E	N	E	T	K	A	D	I

- "Njerëzimi nuk mund të kthehet pas në shpella. Jemi mjaft shumë!"
- Zotat na kanë dhënë dhuratën më të madhe: ne mund ta krijojmë realitetin tonë bazuar në besimet tona dhe kufizimi i vetëm është ai në të cilin ne besojmë.
- Le t'i jemi mirënjohës pasqyrës që zbulon vetëm, pamjen tonë të jashtme.
- Sinqeriteti dëbon të shumtët, por mban të drejtët.
- Nuk është se çfarë thonë për ty, por çfarë pëshpërisin.

Thënie të mënçura

